


Rreth një milion euro
kërkohen në muaj
për trajtim mjekësor
jashtë vendit



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

EDHE 25 VJET PAS KËRKOHET DREJTËSI PËR MASAKRËN NË KRUSHË TË MADHE



Përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe lokale kanë kërkuar të martën drejtësi për masakrën e Krushës së Madhe të Rahovecit, në të cilën forcat policore dhe ushtarake serbe patën vlarë dhe

masakruar 243 shqiptarë, ndërsa 893 shtëpi private dhe shoqërore i patën djegur. Në 25-vjetorin e kësaj masacre është bërë edhe përirimi i muzeut, i cili përmban ekspozitën me 200

videointervista me të mbijetuarit e masakrës, 60 artefakte nga të vranët, të zhdukurit e të mbijetuarit, përjetimet e të mbijetuarve dhe rrëfimet për mbijetesën pas luftës

GJENERALLEJTËNANT RRAHMAN RAMA I BASHKOHET PDK-së F. 3



LETRA E UDHËHQËSVE TË SHITIT DËRGUAR BAKOJANISIT, REAGON HARADINAJ: GAMA E ZOTIMEVE NË ATË LETËR ËSHTË SHUMË E GJERË F. 3



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



PERËNDIMI S'LEJON DISKUTIMIN NË OKB PËR FUSHATËN E NATO-S KUNDËR JUGOSLLAVISË F. 2

BISLIMI PARA EURODEPUTETËVE TË PE-SË PËRMEND MASAT NDËSHKUESE NDAJ KOSOVËS F. 6

HOXHA: 77 POLICË KANË DHËNË DORËHQJE VITIN E KALUAR F. 6

EKONOMI



BQK-ja: VLERA E KREDIVE TË REJA PËR MUAJIN SHKURT 2024 ARRITI NË 172.20 MILIONË EURO F. 8

AUV KËRKON MASA TË BIOSIGURISË NË FERMAT E DERRAVE F. 8

SPORT



SOT FILLON LIGA UNIKE, MARRIN PJESË KATËR SKUADRA NGA KOSOVA DHE KATËR NGA SHQIPËRIA F. 12

Perëndimi s’lejon diskutimin në OKB për fushatën e NATO-s kundër Jugosllavisë

NJU-JORK, 26 MARS - Në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Shtetet e Bashkuara, Franca dhe shtetet e tjera perëndimore, abstenuan në votim duke parandaluar futjen në agjendë të diskutimit temën për ndërhyrjen ushtarake të NATO-s ndaj ish-Republikës Federale të Jugosllavisë 25 vjet më parë. Rusia kishte kërkuar që pika e titulluar “kërcënimet ndaj paqes ndërkombëtare dhe sigurisë” të futej në agjendën e takimit të 25 marsit në Këshillin prej 15 anëtarësh. Franca dhe ShBA-ja argumentuan se agenda e një takimi miratohet nga të gjithë anëtarët, prandaj Rusia pas votimit kërkoi zyrtarisht që kjo pikë të futej në rend dite më vonë gjatë 25 marsit dhe Japonia, që kryeson Këshillin, u pajtua me këtë gjë. Ambasadori rus në OKB, Vasily Nebenzya, tha se çështja e ndërhyrjes së NATO-s nuk është çështje historike, por Kosova, sipas tij, mbetet në agjendën e Këshillit, pasi tha se situata në këtë shtet është përkeqësuar së fundi. Ai tha se ndërhyrja ushtarake e aleancës ishte “shkelje e madhe e ligjit ndërkombëtar” dhe Kartës së OKB-së. “Më 24 mars, koalicioni i aleancës të udhëhequr nga ShBA-ja bombarduan Jugosllavinë nën pretekstin e ndaljes së pastrimit etnik në Kosovë. Në fakt, policia dhe ushtria po luftonin kundër bandave të armatosura në

Kosovë”, tha ai, duke iu referuar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që, siç pretendoi ai, nga “propaganda perëndimore” pjesëtarët e saj “u shndërruan në luftëtarë të së mirës”. ShBA-ja tha se ka mbështetur fushatën 78-ditore kundër çaqeve policore dhe ushtarake të ish-Jugosllavisë, dhe përfaqësuesi i saj në OKB, tha se ishte një veprim “i nevojshëm dhe legjitim për t’i dhënë fund spastrimit etnik në Kosovë”. “Abstenuam për shkak të qasjes së Rusisë. Ne mund të mbështesim një takim në një format të duhur që adreson ngjarjet e vitit 1999. Nuk mund të mbështesim një takim që haptas instrumentalizon ngjarjet tragjike të shekullit të kaluar për të çuar përpara një fushatë propaganduese”, tha përfaqësuesi i ShBA-së, duke shtuar se qëllimi i Rusisë është që të nxisë tensione dhe ta destabilizojë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Përfaqësuesi i Francës tha se sjellja e tillë e Rusisë nuk u kontribuon përpjekjeve që Kosova dhe Serbia t’i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre dhe këtë, sipas Parisit, e di edhe Moska. “Rusia në mënyrë cinike po përdor çështjen e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s më 1999 dhe po tenton ta justifikojë luftën e saj kundër Ukrainës, siç ka bërë në të kaluarën, për ta justifikuar politikën e saj të jashtme agresive në Gjeorgji dhe Krime”, tha ai. Ndërkaq, Kina, që njësoj sikurse




Rusia nuk njeh pavarësinë e Kosovës, po ashtu përkrahu Rusinë dhe tha se ndërhyrja e NATO-s ishte shkelje e ligjeve ndërkombëtare. Përfaqësuesi i Kinës tha se gjatë fushatës ajrore të aleancës ushtarake perëndimore ishte sulmuar edhe Ambasada e Kinës në Beograd, kur ishin vrarë edhe tre gazetarë kinezë. “Kjo ishte shkelje flagrante e sovranitetit të Kinës”, tha ai. Në fund të takimit, përfaqësuesja e Japonisë - shteti që ka kryesimin e Këshillit të Sigurimit - tha se është dakord të mbahet një seancë e hapur me kërkesë të Rusisë, por për caktimin e orës do të merren vesh me palët. Në Nju-Jork, ku ka selinë OKB-ja,

gjendet edhe ministria për Punë të Jashtme dhe Diasporë e Kosovës, Donika Gërvalla. Në ShBA, po ashtu, janë të pranishëm edhe përfaqësuesit e qeverisë serbe. Më 24 mars u bënë 25 vjet nga nisja e sulmeve ajrore të Aleancës Veri-Atlantike kundër çaqeve ushtarake policore në ish-Jugosllavi. Pas 78-ditësh të sulmeve, bombardimet u ndërpre në 10 qershor 1999, me miratimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Kjo rezolutë ishte një kompromis i pesë vendeve të përhershme anëtare të Këshillit të Sigurimit në bazë të së cilës, në Kosovë vendosej një administratë e

Kombeve të Bashkuara, UNMIK, e cila administronte fazën transitore deri në ngritjen e institucioneve vendore dhe zgjidhjen e përhershme të statusit të Kosovës. Ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Kosovë mundësoi kthimin në shtëpitë e tyre të më shumë se 800 000 persona të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës. Më 12 qershor 1999 në Kosovë filloi vendosja e rreth 50 000 ushtarëve nga 36 vende të botës, prej të cilëve 30 000 ishin nga vendet e NATO-s. Njëzet e pesë vjet pas kësaj ndërhyrjeje, në misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, ka numër shumë më të vogël të ushtarëve, 4 700 sosh.

Shembet një urë në Baltimor të ShBA-së, veturat bien në ujë

BALTIMOR, 26 MARS - Një urë e madhe në Baltimor të Shteteve të Bashkuara është shembur pasi u godit nga një anije e madhe të martën në mëngjes dhe, si pasojë, disa vetura ranë në lumin nën të. Ekipet e shpëtimit janë duke kërkuar për të mbijetuar në ujë. Dy njerëz u nxorën nga uji, njëri në gjendje të rëndë shëndetësore, tha shefi i Departamentit të Zjarrfikësve në Baltimor, James Wallace. Ai tregoi se autoritetet “mund të jenë duke i kërkuar shtatë njerëz”, por shtoi se ky numër mund të ndryshojë. Nuk është e qartë nëse dy të shpëtuarit u përfshinë në këtë numër. Anija e goditi njërën prej shtyllave mbajtëse të urës Francis Scott Key, duke e shkaktuar shembjen e saj. Anija shpërtheu në zjarr. “Kjo është një gjendje serioze emergjente”, tha Kevin



Cartwright, drejtor për Komunikim në Departamentin

e Zjarrfikësve në Baltimor. “Përqendrimi ynë tani është të

tentojmë t’i shpëtojmë këta njerëz”, tha Cartwright.

Ai tha se është shumë herët të dihet se sa njerëz janë prekur nga ky incident, por ekipet e shpëtimit janë duke i kërkuar shtatë njerëz në ujë dhe e cilësoi shembjen e urës si “një ngjarje që mund të ketë shumë viktime”. Cartwright tha se anija quhej “Dali”. Ajo po lundronte përmes Baltimor në drejtim të Kolombos në Shri Lankë, sipas autoriteteve. Sipas një zyrtari të Rojës Bregdetare të Baltimor, anija po lundronte nën flamurin e Singaporit, raportoi radio WTOP. “Të gjitha korsitë nga të dyja drejtimet janë mbyllur për shkak të incidentit në I-695 Bridge”, thanë autoritetet e transportit në Mariland. Kryetari i Baltimor, Brandon Scott, tha se ekipet emergjente janë në vendin e ngjarjes dhe se kanë nisur operacionet e shpëtimit.

Letra e udhëheqësve të shtetit dërguar Bakojanisit, reagon Haradinaj: Gama e zotimeve në atë letër është shumë e gjerë

EPOKA ERE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 MARS - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka reaguar ndaj përmbytjes së letrës që udhëheqësit e shtetit, Vjosa Osmani, Glauk Konjufca dhe Albin Kurti, ia kanë dërguar raportueses së KiE-s, Dora Bakojanis. “E kuptueshme që letra e tre krerëve shtetërorë dërguar raportueses së KiE, Dora Bakojanis, mund të jetë standard para aplikimit për anëtarësim në Këshillin e Evropës, por kurrësi nuk mund të cilësohet formalitet, siç e quan pushteti, sepse gama e zotimeve në atë letër është shumë e gjerë dhe përfshin obligime konkrete. Ata zotohen se do të zbatojnë të gjitha nenet e marrëveshjeve të Brukselit e Ohrit, duke përfshirë edhe Asociacionin. Pyetja është, pse kanë pasur nevojë që deri me tash ta zhagisin zbatimin e kësaj marrëveshjeje e të thonë herë e

zbatojmë herë nuk e zbatojmë”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”. Ai ka theksuar se: “Psh. thuhet se liderët institucionalë zotohen se “do të respektohet pavarësia e gjyqësorit dhe do të hiqet dorë nga “kritikat e tepruara ndaj gjyqësorit”. Kjo d.m.th se këta zotohen të heqin dorë nga diçka që e kanë aplikuar deri me tash. Aty thuhet ‘Të përmbahemi nga përdorimi i policisë speciale në veri të Kosovës për detyra të zakonshme policore e të sigurohemi se ato dislokohen vetëm në rast nevojë’, që i bie se deri më tash nuk e kanë zbatuar këtë standard që aq shpesh është kërkuar nga aleatët tanë”. Sipas Haradinajt, udhëheqësit e shtetit, Vjosa Osmani, Glauk Konjufca dhe Albin Kurti, zotohen për shpronësimet në veri, për mbrojtjen e pronave të Kishës Ortodokse Serbe, për integrimin e pakicave, për gjuhët e tyre, shkollimin, tekstet e kështu me radhë. “Anëtarësimi i



Kosovës në Këshillin e Evropës është ngjarje e madhe dhe hap i rëndësishëm drejt integritetit në BE dhe ndoshta letra e zotimeve drejtuar Bakojanis përfshihet në këtë kuadër, por është e habitshme se si liderët

institucionalë të Kosovës, deri me tash kanë shpërfillur kërkesat e njëjta nga nivele shumë të larta të ShBA dhe BE, dhe pikërisht për këtë sot jemi edhe nën sanksione, edhe në marrëdhënie shumë të acaruar me ShBA e BE, edhe të

detyruar t'i përsërisim zgjedhjet në veri, edhe të merremi me dinarin, edhe në pozitën më të keqe të mundshme në procesin e dialogut me Serbinë”, ka theksuar lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.

Gjeneralletënant Rrahman Rama i bashkohet PDK-së

Prishtinë, 26 mars - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka mirëpritur anëtarin më të ri të partisë, gjeneralletënant Rrahman Ramën. Kryetari Krasniqi e ka falënderuar Ramën për besimin në PDK, duke thënë se ai është patriot i dëshmuar, i cili është i shquar për kontributin e tij shumëvjeçar për vendin kudo dhe kurdo që e ka kërkuar nevoja. “Gjeneralletënant Rrahman Rama ka një jetë kushtuar përpjekjeve për çlirim dhe shtetndërtim. Komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në zonën operative të Shalës më 1998-99. Komandant i TMK-së pas luftës në Kosovë. Nga viti



2015 deri në vitin 2021 ishte komandant i Forcës së Sigurisë

së Kosovës nën leadershipin e të cilit kjo forcë gëzoi ditët e saj më

të mira. Një komandant që ndërtoi ura të fuqishme bashkëpunimi në shërbim të forcimit të ushtrisë sonë me të gjithë aleatët tanë, posaçërisht ShBA-në. Një personalitet që ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në të gjitha fazat e transformimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Ushtrinë zyrtare të Republikës së Kosovës, si shtet i pavarur dhe sovran”, theksoi Krasniqi. Ndërkaq Rrahman Rama tha se misioni jetësor dhe krenaria e tij më e madhe është shërbimi ndaj Kosovës dhe largimi i tij nga FSK ishte përmbytje e misionit të tij ushtarak, por jo për t'i shërbyer atdheut. “Sot po i bashkojem shtëpisë së madhe politike -

Partisë Demokratike të Kosovës, për t'i shërbyer vendit në një cilësi tjetër. PDK është parti shtetformuese e shtetndërtuese, e cila Republikën e Kosovës e ka të shenjtë dhe nuk mund ta lë në mëshirë të fatit pavarësisht pozicionit të saj. Sidomos në një periudhë të tillë të vështirë, kur sfidat e vendit tonë janë të shumta. E posaçërisht, sfidat në fushën e sigurisë. Sot detyrë e secilit prej nesh është që me të gjitha kapacitetet tona të angazhohemi për ta nxjerrë vendin nga kjo gjendje, e së bashku të ecim përpara në rrugën drejt fuqizimit të shtetit dhe përparimit e integritetit të tij. Për Kosovën jemi bashkë”, ka thënë Rama.

Byrnes: Jakup Krasniqi jetonte sipas parimeve të besës, ne kishim besim tek ai

Hagë, 26 mars - Gjatë dëshmisë së tij në Hagë, dëshmitari Shaun Byrnes ka thënë se Jakup Krasniqi ishte njeri që jetonte sipas parimit të besës dhe se tek ai kishte besim. Dëshmitari ka thënë se gjatë takimeve që kishte pasur me Jakup Krasniqin, ai ishte i arsyeshëm dhe kishte marrëdhënie të mira me të, raporton “Betimi për Drejtësi”. “Gjatë asaj kohe unë isha i mendimit që ne kishim krijuar një besim të ndërsjellë me njëri-tjetrin dhe në të gjitha ato takime që ne kemi pasur, në një sërë krizash që ndodhën ai

punoj fortë, vërtet fortë që të bashkëpunonte me ne. Punoj fort që të zgjidheshin ato kriza. Pjesërisht, ashtu siç e kam thënë edhe këtu, motivimi i tij ka qenë qartazi si një person i leadershipit të UÇK-së që ShBA-ja të ishte në anën e tyre”, ka thënë dëshmitari. Ai ka treguar se Krasniqi ishte nga ata persona që nëse ta jepte fjalën se do të ndodhte diçka, atëherë do të bëhej me të vërtetë. Dëshmitari ka thënë se ka pasur momente që kanë pasur edhe mosmarrëveshje me Krasniqin. “Pra, kishte një shkallë shumë të madhe

besimi ndërmjet nesh. Megjithatë, edhe ne kemi pasur momentet tona me njëri-tjetrin. Kemi pasur mosmarrëveshje, për shembull, mbaj mend një rast kur ai ishte aq i inatosur me mua sa që doli nga dhoma me furi dhe nuk mund ta mbaj mend tani se për çfarë mund të bëhej fjalë sepse ka kaluar kohë që atëherë. E mbaj mend që doli me një shpejtësi të madhe nga dhoma, me gjithë inat, po pastaj u kthye dhe ne punuam, e rregulluam çfarëdo problemi që ka qenë ai. Jam i sigurt që e zgjidhëm”, ka thënë Byrnes.





Edhe 25 vjet pas kërkohet drejtësi për masakrën në Krushë të Madhe

Përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe lokale kanë kërkuar të martën drejtësi për masakrën e Krushës së Madhe të Rahovecit, në të cilën forcat policore dhe ushtarake serbe patën vrarë dhe masakruar 243 shqiptarë, ndërsa 893 shtëpi private dhe shoqërore i patën djegur. Në 25-vjetorin e kësaj masakre është bërë edhe përrurimi i muzeut, i cili përmban ekspozitën me 200 videointervista me të mbijetuarit e masakrës, 60 artefakte nga të vrarët, të zhdukurit e të mbijetuarit, përjetimet e të mbijetuarve dhe rrëfimet për mbijetesën pas luftës

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka kërkuar të martën drejtësi për masakrën në Krushë të Madhe të Rahovecit, në të cilën forcat policore dhe ushtarake serbe patën vrarë dhe masakruar 243 shqiptarë, ndërsa 893 shtëpi private dhe shoqërore i patën djegur.

Në përrurimin e Muzeut në 25-vjetorin e masakrës në këtë fshat, Osmani ka thënë se muzeu do të jetë në funksion për krimet që Serbia i ka kryer ndaj qytetarëve

të Kosovës. Ajo ka thënë se zërat e viktimave nuk do të heshtën e as harrohen nëpërmjet dokumentimit me rastin e inaugurimit të këtij muzeu. "Sot jemi këtu të gjithë së bashku për ta kujtuar një mizori ku regjimi gjenocidal i Serbisë ekzekutoi qindra burra, djem, fëmijë dhe gra shtatzëna. Sot jemi këtu për të kërkuar që të zbardhet fati i të zhdukurve. Sot jemi këtu për të kujtuar edhe intelektualin Ukshin Hoti. Mbi të gjitha, sot jemi këtu për ta institucionalizuar kujtesën tonë kolektive. Ky muze është në funksion të thirrjes sonë të përbashkët në drejtësi e cila

akoma mungon. Ne nuk duhet ta harrojmë rrugën nëpër të cilën kemi kaluar. Pikërisht në krye të këtij mision kanë qenë krushjanët", ka thënë Osmani. E para e shtetit ka thënë se inaugurimi i muzeut, njësojë sikurse liria, janë rezultat i sakrificës së popullit shqiptar. "Ata nuk ia dolën në misionin e shfarosjes së popullit shqiptar. Duke kujtuar viktimat e mizorive, kujtojmë dinjitetin e tyre e sakrificën e tyre. Familjet kanë nevojë për liri, Kosova ka nevojë për drejtësi. Zërat e viktimave ende kumbojnë. Prej sot ky muze do të jetë në funksion të atyre për

krimet që Serbia i kreu për qytetarët e Kosovës. Ky muze, sikurse liria jonë, janë rezultat i sakrificës sonë për liri dhe sakrificës së aleatëve tanë. Ky muze është historia jonë e dhimbshme, por uroj që të mos jetë historia e askujt. Asnjëherë nuk ndalojmë së kërkuari që autorët të dalin para drejtësisë", ka thënë ajo.

Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se inaugurimi i muzeut që dokumenton këtë ngjarje, është tregues i çmimit të Kosovës për liri. Ai tha se mbi 140 të vrarët e personat e zhdukur nga kjo masakër kanë pësuar vetëm për shkak të etnisë së tyre shqiptare. "Ky muze do të trokasë në ndërgjegjen tonë dhe të atyre që vijnë pas nesh, duke na treguar çmimin e lartë që kemi paguar për lirinë e tokës sonë. Masakra e Krushës së Madhe është një nga masakrat më masive që u bë nga ushtria e shtetit terrorist të Serbisë, për pak kohë u dogjën mbi 800 shtëpi dhe u shkatërrua gjithçka që lidhte me trashëgiminë tonë kulturore", ka thënë Latifi.

shumë fshatarëve, u asgjësuan monumentet e trashëgimisë kulturore e historike dhe u rrënua gjithçka që lidhej me trashëgiminë tonë kombëtare", ka thënë Latifi, duke shtuar se kujtesa jonë për marsin e 1999-s mbetet njësoj e freskët. "Luftën, djersën, mundin e gjakut ia kemi borxh vendit. Kjo tokë është larë shumë herë më gjak, megjithatë kemi qëndruar këtu dhe kemi ruajtur varret e të parëve. Për të mos harruar mundin e djersën e tyre, ne kemi investuar në rregullimin dhe mirëmbajtjen e varreve dhe kemi ngritur edhe muzeun e masakrës. Është një nga masakrat më masive që u bë nga ushtria e shtetit terrorist të Serbisë, për pak kohë u dogjën mbi 800 shtëpi dhe u shkatërrua gjithçka që lidhte me trashëgiminë tonë kulturore", ka thënë Latifi.

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se nëpërmjet inaugurimit të muzeut të masakrës së Krushës së Madhe ruhet kujtesa kolektive për gjenocidin e Serbisë në Kosovë.

Masakra e Krushës së Madhe po tregohet dhe dokumentohet përmes rrëfimeve të të mbijetuarve

Prishtinë, 26 mars - Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës është bërë promovimi i një botimi shumë të rëndësishëm për historinë tonë. Një vëllim i librave që përfshin transkriptimin e 200 intervistave të dëshmitarëve dhe të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe. Në këtë hulumtim janë përfshirë 33 hulumtues dhe është mentoruar nga profesorët Arsim Canolli, Tahir Latifi dhe Shemsi Krasniqi. Në emër të Qeverisë së Kosovës, në këtë ngjarje ka folur ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e cila ka theksuar se këto vëllime nuk do të na shërbejnë vetëm neve, por edhe gjeneratave të reja që krimet e bëra nga Serbia në Kosovë të mos harrohen kurrë. Fjalë rasti kanë mbajtur edhe kryetari i Këshillit Drejtues të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, Bardh Rugova, profesori Tahir Latifi dhe Miradije Ramadani, e mbijetuar e masakrës së Krushës

së Madhe. Në ngjarje morën pjesë edhe ministri Hajrulla Çeku, ambasadori i Austrisë, George Schnetzer, ambasadori i Anglisë, Jonathan Hargreaves, ambasadori i Malit të Zi, Bernard Çobaj, u. d. e drejtorit të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”, Bukurie Haliti, kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, mentorët e projektit Arsim Canolli, Tahir Latifi, deputetë të Kuvendit të Kosovës, familjarë të të vvarëve të masakrës së Krushës së Madhe, dëshmitarë dhe të mbijetuar të kësaj masakre. Aktiviteti që u organizua në përvjetorin e masakrës u mbyll me ekspozitën në të cilën pasqyrohen disa fragmente nga videointervistat e transkriptuara të të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe. Hulumtimi dhe botimi i librave është përkrahur nga Ministria e Kulturës.



“Ky muze do t’i kontribuojë kujtesës sonë kolektive për të mos harruar asnjëherë krimet mizore dhe aktet gjenocidale të Serbisë fashiste”, u shpreh Haxhiu. Ajo ka treguar se së fundmi është themeluar Instituti për Dokumentimin dhe Hulumtimin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës së fundit në Kosovë, në të cilin do të dokumentohen të gjitha masakrat dhe krimet e tjera që janë kryer në Kosovë.

Kurti përkujton masakrën nga forcat serbe në Suharekë dhe Krushë të Madhe e të Vogël

Kryeministri i vendit, Albin Kurti, në 25-vjetorin e masakrës nga forcat serbe në Suharekë dhe Krushë të Madhe e të Vogël, ka shkruar se në pranverën e vitit

1999 Serbia po realizonte planin gjenocidal “Patkoj” për shfarosjen e popullsisë shqiptare vendase në Kosovë. “Në pranverën e vitit 1999 Serbia po realizonte planin gjenocidal ‘Patkoj’ për shfarosjen e popullsisë shqiptare vendase në Kosovë. Në paraditën e 26 marsit, forcat e Serbisë sulmuan fshatrat Krushë e Madhe dhe Krushë e Vogël. I detyruan gratë dhe fëmijët të largoheshin për në Shqipëri. Burrat dhe djemtë i ndaluan. Ua konfiskuan letërnjoftimet dhe artikujt me vlerë. Pastaj hapën zjarr me mitraloz mbi ta. Të shtënat zgjatën disa minuta”, ka shkruar Kurti në “Facebook”. Kurti në të njëjtin postim ka shkruar edhe për masakrën në Padalishtë të Skenderajt, për vrasjet në Landovicë të Prizrenit e në Gjakovë. “Atë ditë, forcat serbe vranë 243 civilë shqiptarë në masakrën në Krushë të Madhe dhe 113 në Krushë të vogël. Në

orët e hershme të mëngjesit të 26 marsit, tanket serbe rrethuan oborrin e familjes Berisha në Suharekë. I dëbuan familjarët nga shtëpitë dhe i çuan në një kafene. Pastaj hapën zjarr. Hodhën edhe eksplozive. Forcat serbe aty i vranë 48 anëtarë të familjes Berisha, përfshirë 11 fëmijë. Mes tyre, Dorentinën 3-vjeçare, Ismetin 2-vjeçar, ndërsa Eroni dhe Redoni ishin vetëm 1 vjeç. Trupat e tyre u dërguan në varrezë masive në Batajnicë, afër Beogradit. Kësaj masakre i mbijetuan vetëm Shyhrete Berisha dhe Vjollca me të birin, Gramoz Berisha. Po atë mëngjes, forcat serbe e sulmuan fshatin Padalishtë të Skenderajt, duke masakruar 19 anëtarë të familjes Imeraj, nga moshë 2 deri 76 vjeç. Në

mesin e tyre 11 gra dhe pesë fëmijë”, ka shkruar Kurti, duke shtuar se në Landovicë të Prizrenit, më 26 mars 1999, u vranë 23 banorë të këtij fshati dhe fshatrave të tjerë, përfshirë gjashtë fëmijë dhe një grua shtatzënë. “Në mbremje, në qytetin e Gjakovës, në një shtëpi në rrugën “Ymer Grezda”, forcat e Serbisë vranë me armë zjarri të gjashtë burrat shqiptarë që ishin në atë shtëpi. Këto janë dëshmitë e gjenocidit të Serbisë, që me forcat policore e ushtarake, u përpoq të shfarosë shqiptarët në Kosovë”, ka shkruar Kurti. Në 25-vjetorin e kësaj masakre morën pjesë edhe ambasadorët e huaj të akredituar në vendin tonë, liderë të opozitës, deputetë të Kuvendit të Kosovës, zyrtarë të Policisë së Kosovës dhe të FSK-së.



Konjufca priti në takim eurodeputetët e PE-së, theksohet angazhimi për proceset e eurointegritimeve

PRISHTINË, 26 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të martën në takim eurodeputetët Thijs Reuten dhe Ladislav Ilčíq, pjesë e delegacionit të Parlamentit Evropian dhe Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit BE-Kosovë.

Kryetari Konjufca i falënderoi eurodeputetët për vizitën si dhe u shprehu mirënjohje për kontributin e tyre në kuadër të Komisionit Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim, duke theksuar rëndësinë e madhe të këtij procesi në marrëdhëniet në mes të Republikës së Kosovës dhe BE-së, pjesë e rrugës për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Eurodeputetët Reuten dhe

Ilčíq e falënderuan kryetarin e Kuvendit për mikpritjen dhe i shprehën mbështetjen ndaj Republikës së Kosovës dhe angazhimin e përbashkët për të avancuar përpara në proceset e eurointegritimeve. Takimi u realizua në prag të nisjes së Takimit të 11-të të Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit BE - Kosovë.



Bislimi para eurodeputetëve të PE-së përmend masat ndëshkuese ndaj Kosovës

PRISHTINË, 26 MARS - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur të martën eurodeputetët nga Parlamenti Evropian, Thijs Reuten dhe Ladislav Ilčíq. Zëvendëskryeministri Bislimi pranoi simbolikisht nga eurodeputeti Reuten, i cili ishte dhe raportues mbi çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën, penën me të cilën u nënshkrua më 19 prill të vitit të kaluar, vendimi final për procesin. Gjatë takimit u bisedua mbi rrugëtimin e Kosovës drejt integritimit në Bashkimin Evropian, ku zëvendëskryeministri përmendi aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE dhe nevojën për ecjen tutje në këtë proces, angazhimin e vendit sa i përket Planit të Rritjes dhe punës për reformat indikative, por edhe performancën e vendit përmes



indikatorëve ekonomikë.

U ngritën dhe çështje që ndërlidhen me fusha si energjia, shëndetësia, arsimi. Gjithashtu u adresuan masat ndëshkuese ndaj Kosovës, ku zëvendëskryeministri ritheksoi se ato janë të padrejta dhe duhet të hiqen sa

më parë. Nga ana e tyre, eurodeputetët Reuten dhe Ilčíq nënvizuan se Parlamenti Evropian e mbështet Republikën e Kosovës në objektivin dhe qëllimin e saj në rrugëtimin integruar drejt Bashkimit Evropian, duke theksuar dhe

mirënjohjen për qëndrimin parimor e mbështetjen ndaj qasjes evropiane kundrejt agresionit të pajustificuar rus në Ukrainë. Duke i falënderuar eurodeputetët për përkrahjen e vazhdueshme të tyre dhe të Parlamentit Evropian

ndaj Republikës së Kosovës, zëvendëskryeministri Bislimi vlerësoi pikëpamjet e ndara dhe diskutimet gjithmonë produktive. Në këtë takim ai shoqërohej nga ambasadori i Kosovës në Bruksel, Agron Bajrami.

Hoxha: 77 policë kanë dhënë dorëheqje vitin e kaluar



PRISHTINË, 26 MARS - 77 zyrtarë policorë kanë dhënë dorëheqje gjatë vitit të kaluar, ka bërë me dije drejtori i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, gjatë raportimit në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Ky trend, sipas Hoxhës, ndodh në gjithë botën. “Gjatë vitit të kaluar 77 zyrtarë policorë dhe staf civil kanë dhënë dorëheqje. Është trend në gjithë botën, e tek ne po vazhdon”, tha Hoxha. Në fushën e rendit dhe sigurisë publike, Hoxha tha se Policia e Kosovës ka zhvilluar bashkëpunim me qytetarë, media, forume, përkundër sfidave të paraqitura. “48 mijë raste të raportuara, 3.55 % rritje krahasuar me vitin paraprak. Dy

muajt e këtij viti ka pasur rritje të raportimit në përgjithësi. Disa prej veprave më të rënda, vrasje nga 21 në 29, lëndim i rëndë 295, vjedhje e rëndë -1.96 %, grabitje në tentativë ulje të rasteve, rritje të rasteve ndëretnike, zbulim i veprave 79 % me rritje 3 %, 55 raste të vjedhjeve, asistime të gjykatave, KEDS-it, municion i konfiskuar, trafik rrugor fatalitet 96, 14 mijë me dëme në aksident”, tha Hoxha. Ai ka bërë me dije se ka rënie të aksidenteve me fatalitet. Në vitin 2023, 106 të vdekur në krahasim me vitet e tjera paraprake kur numri ishte më i madh. 1 094 kallëzime penale, kontroll kufiri, 27 milionë persona e kanë frekuentuar kufirin.

Filloi lirimi i hapësirave publike në Prishtinë, largohen tarracat në Lakrishtë

PRISHTINË, 26 MARS - Inspektorati i komunës së Prishtinës ka filluar lirimin e hapësirave publike

(largimin e tarracave) në zonën përreth kompleksit banesor në lagjen Lakrishtë. Kjo u bë me dije

përmes një postimi në faqen “Kryeqyteti Prishtina”, në rrjetin social në “Facebook”. Në këtë

postim përmes publikimit të disa fotografive shihen se si janë duke u larguar këto tarraca.



Rreth një milion euro kërkohen në muaj për trajtim mjekësor jashtë vendit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 MARS - Zëvendësudrejtori i Fondit për Sigurime Shëndetësore, Bujar Kaçuri, gjatë raportimit në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ka thënë të martën se Qeveria e Kosovës i ka ndarë 15 milionë euro shtesë këtij fondi për programin për trajtim jashtë vendit. Ai ka bërë me dije se mbi 800 lëndë janë shqyrtuar dhe aprovuar nga bordi për trajtim jashtë vendit, të gjitha ato lëndë të cilat i kanë plotësuar kriteret me Udhëzimin e ri Administrativ. “Vlera e përgjithshme e shpenzimeve në kuadër të programit për trajtim jashtë vendit është mbi 22 milionë euro. Vlera e kërkesave mujore është rreth 1 milion euro për trajtim jashtë vendit”, ka thënë Kaçuri.

Kaçuri ka shtuar se në raportin e fundit të dërguar në Ministrinë e Financave shuma totale e obligimeve është 15 milionë euro duke përfshirë ato kontingjente dhe obligimet e rregullta. “Me Udhëzimin e ri Administrativ kemi bërë një bazë të mirë ligjore që ka eliminuar procesin e parapagimit për rastet e rregullta, sepse në ta kaluarën rastet e rregullta janë parapaguar në bazë të pro-faturës të dorëzuar nga ana e pacientëve dhe bordi për trajtim jashtë vendit në bazë të dokumentacionit mjekësor

dhe financiar ka aprovuar kërkesën, mirëpo nuk është ditur asnjëherë saktë vlera e shërbimit që ka marrë pacienti”, ka thënë ai.

Kaçuri u shpreh se ka ndodhur që vlera e pro-faturës ka qenë 10 mijë euro, ndërsa vlera e shërbimit të pacientit të marrë është 8 mijë euro dhe 2 mijë euro kanë mbetur të lira. “Kjo metodë është ndërprerë dhe është përcaktuar se kërkesat për rastet e rregullta së pari bëhet aprovimi i kërkesës nga ana e bordit për trajtim jashtë vendit, ku merret vendim për aprovimin e kërkesës për fillimin e trajtimit, ndërkohë pala pasi të marrë shërbimin shëndetësor është e obliguar që në fund të sjellë faturën dhe raportin mjekësor për shërbimet e marra. Nëse nuk i sjellë, nuk mund të aprovohet kërkesa”, ka thënë u Kaçuri.

Bordi i Sigurimeve Shëndetësore është ndryshuar pas shkeljeve të Udhëzimit Administrativ

Edhe ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, gjatë raportimit në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me raportin e auditimit të performancës “Efektiviteti i programit për trajtimin e pacientëve jashtë institucioneve



shëndetësore publike”, ka theksuar se në vitin 2022 kishin kërkuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit që të kryente një raport auditimi pas situatës së krijuar në ShSKUK-ja dhe në Fondin për Sigurime Shëndetësore.

Vitia ka thënë se në vitin 2022 kishin kërkuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit që të kryente një raport auditimi pas situatës së krijuar në ShSKUK dhe në Fondin për Sigurime Shëndetësore. “Ne kemi kërkuar auditimin në vitin 2022, kërkesë që erdhi pas shkarkimeve që ndodhën në fond dhe evidentimit të një gjendjeje të rënduar. Nga Ministria e Financave i është bërë kërkesë

më 20 tetor 2022 Zyres Kombëtare të Auditimit për t'i audituar mospërputhjet në pasqyrat financiare dhe rrjedhimisht performancën e vendimeve të trajtimeve jashtë vendit. Për këtë po zhvillohen edhe hetime”, ka thënë Vitia. I pyetur nga kryetarja e këtij komisioni, Hykmete Bajrami, se a është ndërruar bordi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore sepse në të kaluarën shihet se kanë bërë shkelje të Udhëzimit Administrativ, Vitia u përgjigj se bordi është ndryshuar. “Bordi është ndryshuar komplet. Në

udhëzimin e kaluar administrativ si problematik ka qenë komisioni konsiliar dhe ai mjekësor, ku shpeshherë komisioni konsiliar për arsye ‘X’ një pacienti i ka dhënë leje për të shkuar jashtë institucioneve shëndetësore publike me arsyetimin se mungon ky bari ose një aparaturë është prishur, pastaj komisioni e ka analizuar dhe pastaj ka pasur shumë paqartësi, sepse dy komisione profesionale kundër njëra-tjetrës nuk e kanë pasur përgjegjësinë e plotë”, është shprehur Vitia.

Vitia: Të gjithë invalidët e UÇK-së do të kompensohen për proteza të reja

Gjatë raportimit në Komisionin Parlamentar për Buxhet dhe Financa, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka folur edhe për shërbimin e veteranëve me proteza të reja, duke thënë se do të bëhet kompensimi i tyre me proteza të reja. “Sa iu përket invalidëve, shumica kërkesave janë bërë në nëntor-dhjetor 2023, përveç dy, tri kërkesa që janë nga muaji gusht i vitit të kaluar, e kur kemi parë që janë analizuar të gjitha rrugët dhe

e gjithë qeveria, jo vetëm ministria, ka pasur ndjeshmërinë maksimale të gjendet njëherë e mirë që të institucionalizohet i gjithë ky proces e të shkojë përmes Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Nga vendimi që kemi marrë para pak ditësh në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe të gjitha këto kërkesa janë miratuar dhe të gjithë invalidët e UÇK-së do të kompensohen për mirëmbajtjen për proteza të reja”, ka thënë Vitia.



Maqedonci takon zyrtarin e Ministrisë së Mbrojtjes së Turqisë, flasin për sigurinë

PRISHTINË, 26 MARS - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka takuar të martën shefin e Departamentit për Marrëdhënie me Jashtë të Ministrisë së Mbrojtjes së Turqisë, gjeneralbrigade Omer Nafiz Gulmezoglu, me të cilin ka biseduar për situatën e sigurisë në vend. “Ishte kënaqësi të pres sot në takim shefin e Departamentit për Marrëdhënie me Jashtë të Ministrisë së Mbrojtjes së Turqisë, gjeneralbrigade Omer Nafiz

Gulmezoglu. Diskutuam rreth situatës së sigurisë në vend, zhvillimin e FSK-së si dhe kërcënimeve që vijnë nga jashtë”, ka shkruar Maqedonci në “Facebook”. Ai e ka falënderuar gjeneralin Gulmezoglu për mbështetjen e pakursyer që Republika e Turqisë i ka ofruar Kosovës nëpër të gjitha fazat e shtetndërtimit, në veçanti në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duke i shprehur vullnetin e fuqishëm për vazhdimin e mëtejme të këtij

bashkëpunimi të ngushtë në mes të dy vendeve. Nga ana e tij, gjenerali Gulmezoglu, siç ka njoftuar ministri, vuri në dukje se Turqia “gjithmonë do ta mbështesë Kosovën për arritjen e qëllimeve të saj strategjike”. Maqedonci ka theksuar se të dy janë pajtuar që ruajtja e paqes dhe stabilitetit në vend dhe rajon përbën prioritet dhe, në këtë aspekt, “do ta vazhdojmë koordinimin me KFOR-in, ku shërbejnë edhe trupat turke”.



ATK-ja ndryshon procedurat e rimbursimeve

PRISHTINË, 26 MARS - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se, bazuar në Ligjin për Administrimin e Procedurave Tatimore, i cili ka hyrë në fuqi nga data 28 janar 2024, ka nxjerrë rregulloren me të cilën p l o t s o n / n d r y s h o n procedurat e rimbursimeve. Qëllimi i kësaj rregulloreje të

brendshme për procedurat e rimbursimeve është që përmes krijimit të procedurave të shkruara të përcaktohen veprimet ligjore që do të ndërmerren në rastet kur bëhet fjalë për zbatimin e dispozitave ligjore për rimbursime të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh), Tatimit në të Ardhurat Personale (TAP) dhe Tatimit në

të Ardhurat e Korporatave (TAK). Kjo rregullore e brendshme shfuqizon “Rregulloren e brendshme mbi procedurat e Rimbursimeve nr. 2/2023, të datës 25.09.2023, me nr. Protokolli 09-06-3613”. Kjo rregullore e brendshme hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga drejtori i përgjithshëm i ATK-së.



Shahini: 400 biznese janë mbyllur për tre muaj

PRISHTINË, 26 MARS - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka thënë për “Ekonomia Online” se brenda tre muajve në Kosovë janë shuar afër 400 kompani. Këtë fakt, Shahini e sheh shqetësuese, teksa pret veprime institucionale. “Është shqetësim për vendin, po flasim aktualisht për tre muajt e fundit ku mesatarisht janë mbyllur rreth 400 kompani e që këto kompani kryesisht janë mbyllur për shkaqe të problemeve të njëpasnjëshme që kanë pasur për shkak të humbjes së fuqisë në treg të borxheve dhe të konkurrencës jo fer”, ka theksuar Shahini.

Ai ka thënë se shuarja e bizneseve nuk mund të jetë vullnetare përderisa ata nuk kanë arritur objektivat e veta. “Asnjë biznes nuk mbyllet vullnetarisht që i ka punët mirë, por që i ka punët keq. Kjo kupton që Kosova nuk është

vend atraktiv për bizneset e reja. Gjithashtu, edhe bizneset me traditë janë duke shkuar drejt falimentimit për arsye të ndryshme të goditjeve të njëpasnjëshme që vijnë në biznes”, ka thënë kryetari i AKB-së, Agim Shahini.

Ai ka thënë se mundësitë e reja zhvillimore ato të investimit si dhe mbështetëse janë tre faktorë tejet të rëndësishëm për t’u zhvilluar një biznes. “Qeveria duhet të bëjë edhe më shumë për të krijuar mundësi të reja zhvillimore, mundësi të reja investuese dhe mbështetëse. Pra duke i pasur këta tre faktorë të rëndësishëm ne e mbajmë aktive ekonominë e vendit. Bizneset janë tepër të angazhuara, e qeveria duhet të bëjë gjithçka që ato të mos mbyllen, sepse ka ngarkesa të larta tatimore dhe interesi bankar është i lartë”, ka thënë Shahini.



AUV kërkon masa të biosigurisë në fermat e derrave



PRISHTINË, 26 MARS - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ka kërkuar që të ngrehen masat e biosigurisë në fermat e derrave. Kjo kërkesë vjen pas lajmërimeve për shpërthime të sëmundjes Murtaja Afrikane e Derrit në shtetet përreth. “Duke u bazuar në situatën epidemiologjike të raporteve të publikuara në WOA (Organizata Botërore për Shëndetin e kafshëve), ka lajmërimet për shpërthime të sëmundjes Mortaja Afrikane e Derrit në shtetet përreth, në Shqipëri dhe Mal të Zi tek popullata e derrave të egër. Së fundmi janë prekur fermat e

derrave të butë në shtetin e Serbisë në afërsi me kufirin e Kosovës. Andaj urdhërohen të gjithë fermerët mbajtës të derrave që të ngritin nivelin e biosigurisë (masat vetëmbrojtëse) në fermat e tyre. Duke aktivizuar barrierat me dezinfektues dhe kufizim të hyrje daljeve në ferma. Përmes së cilave synohet të mbrohen ekonominë familjare të fermerëve dhe ekonominë e shtetit”, është thënë në njoftimin e AUV-së. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë kërkon ngritjen e nivelit të gatishmërisë për institucionet relevante lokale dhe

qendrore siç janë komunat, MBPZhR, APK, Federata e Gjuetarëve të Kosovës me shoqatat e tyre në nivel vendi, për marrjen e masave të nevojshme për rastet e dyshimta nga terreni. “Secili qytetar e në veçanti fermerë duhet të lajmëroj nëse sheh ndonjë derr të ngordhur apo nëse ka dyshime në sëmundje tek ferma. Zyrat regionale të AUV-së do të pajisen dhe shpërndajnë materialin informues (postera, broshura) tek fermerët me këshilla të qarta profesionale për parandalimin e përhapjes së kësaj sëmundjeje”, ka njoftuar AUV.

BQK-ja: Vlera e kredive të reja për muajin shkurt 2024 arriti në 172.20 milionë euro

PRISHTINË, 26 MARS - Shtatë miliardë e 400 milionë euro janë asetet e bankave komerciale në Republikën e Kosovës dhe se investimet e këtyre institucioneve jashtë vendit kanë arritur në 1.20 miliard euro. Kështu thuhet në statistikat e bankave komerciale për muajin shkurt 2024, të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), duke shtuar

se vlera e kredive bruto ka arritur në 4.95 miliardë euro me një rritje prej 60.40 milionë eurosh, derisa shuma e depozitave të klientëve është 6.00 miliardë euro.

Sipas raportit, kapitali i bankave komerciale për këtë muaj ishte 894.10 milionë euro. Më tutje, BQK-ja tregon se vlera e kredive të reja ishte 172.20 milionë euro, derisa

shuma e depozitave të reja arriti në 78.70 milionë euro. Po ashtu, norma mesatare e interesit në depozita ishte 2.89 %, ndërsa norma mesatare e interesit në kredi ishte 6.34 %, ku në muajin paraprak ka qenë 6.38 %. Raporti kredi-depozita për këtë muaj ishte në nivelin 82.40 %, kurse margjina e normës së interesit në kredi dhe depozita ishte 3.50 %.



DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (10)



Prof. dr. Sabit SYLA & Prof. dr. Hamit KABA

-44-

Konfidenciale

GRS 210
Fm moskë 280530z, maj '81
Prioritet i lartë
Telegram nr. 303 i datës 28 maj
Për informacion rutinë, Beograd
Telegrami juaj nr. 311 dhe telegrami im nr. 295

Kosova

1. Meqenëse turneu im ishte caktuar, pata mundësinë që të diskutoja çështjen e Kosovës me ministrin në Ambasadën jugosllave këtu.
2. Strbac e pranoi me sinqeritet se shqetësimi i takonte vetë gabimeve të kaluara të Jugosllavisë në trajtimin e pakicës shqiptare po aq sa edhe ndërhyrjes së shqiptarëve. Për shembull, numri i studentëve në Kosovë kishte arritur në 51,000 dhe ishte lejuar që Universiteti të mbante kontakte me Tiranën. Megjithëse Shqipëria i kishte shfrytëzuar mundësitë që ofronte kjo situatë, Strbac e dinte se nuk kishte të dhëna që rusët i kishin inkurajuar ato. Sipas mendimit të tij, qeveria sovjetike ishte e shqetësuar që të mos u jepte jugosllavëve asnjë arsye legjitime për ankesë për këtë rezultat dhe i ka bërë të qartë jugosllavëve mosaprovimin nga ana e tyre të terrorizmit në lidhje me incidentin e bombës në Ambasadën jugosllave në Tiranë në përvjetorin e ditëlindjes së Titos.
3. Natyrisht kjo nuk kundërshton deklaratën e mëparshme të Ambasadës jugosllave që rusët nuk janë “të pakënaqur” për trazirat në Kosovë.

Brooker Turner
[Ky telegram nuk është përcjellë]

-45-

Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq
Ambasada britanike EESD,
Beograd FCO
2 qershor 1981

Kosova: zjarri në Patriarkanën e Pejës

1. Ka patur një zhvillim të ri në historinë e zjarrit misterioz të vënë në Patriarkanën Ortodokse Serbe në Pejë, më 16 mars (referuar në letrat e Terence Clark dërguar për Ju më 22 prill dhe 11 maj).
2. Në një konferencë për shtyp në Prishtinë, më 27 maj, Prokuroria Publike bëri të ditur se janë kryer hetime zyrtare dhe se “ka shumë të ngjarë” që zjarri është shkaktuar nga një qark i shkurtër që rezultonte nga instalime të dobëta elektrike dhe izolime të pamjaftueshme. Në mënyrë alternative zjarri mund të jetë shkaktuar edhe nga një oxhak

me defekte. Sidoqoftë, forcat e brendshme të sigurisë janë udhëzuar që të vazhdonin me hetimet për të hequr çdo dyshim të mbetur.
3. Gazetarëve pjesëmarrës mesa duket nuk u bënë përshtypje këto shpjegime dhe siç raportoi gazeta “Politika”, ata bënë disa pyetje kërkimore. Përgjigjet nuk ishin të mjaftueshme. Si mund të përcaktohej se oxhaku ishte dëmtuar para vënies së zjarrit dhe jo gjatë tij? “Oxhaku ishte dërguar në Beograd për analiza që do të zgjidhnin këtë pikë”. Pse nuk ishte dhënë menjëherë informacioni për vënien e zjarrit? “Faktet nuk njiheshin dhe vetëm hetuesi ishte autorizuar që të jepte informacion”. A kanë funksionuar siç duhet pajisjet me ujë që përdoren nga makinat zjarrfikëse? “Zjarrfikësit kanë argumentuar se ishin përdorur të gjitha mjetet në dispozicion për shuarjen e zjarrit”. Siç e tha edhe gazeta “Politika” (ndoshta mjaft bujarisht), “në tërësi vetëm një pjesë e pyetjeve morën përgjigje, por prokurorët ishin përpjekur në fakt që t'i përgjigjeshin çdo pyetjeje - nëse ishte brenda kompetencës së tyre”.
4. Toni i kujdesshëm, në mos i paqartë i këtyre komenteve zyrtare, nuk do të ndikojë shumë që të largojë dyshimet e serbëve se ishin nacionalistët shqiptarë që vunë zjarrin. Nga ana tjetër, këto komente natyrisht nuk përbënin një konfirmim zyrtar të ngjarjes. Terence Clark raportoi më 11 maj se ishte vendosur në të vërtetë nga policia se bëhej fjalë për rastin e zjarr vënies së qëllimshme. Kështu, mbase nuk kemi dëgjuar lajmet më të fundit në këtë pikë.

I

Juaji, Charles Crawford
Oficer Informacioni

-46-

Konfidenciale

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
EESD, Beograd
3 qershor 1981
FCO

Kosova: situata e brendshme politike

1. Gjatë kësaj jave nuk ka ndodhur asgjë mbresëlënëse që të ndikojë në situatën e përgjithshme në Kosovë qoftë për mirë apo për keq. Fjalimet dhe deklaratat zyrtare tregojnë se autoritetet e shohin veten e tyre përballë një problemi afatgjatë dhe të vështirë në Krahinë. Thirrjet e përsëritura për më pak “takime maratonë” dhe më shumë veprim, si dhe natyra e incidenteve të reja të raportuara në shtyp, sugjerojnë që nëse nuk ka opozitë aktuale ndaj masave të autoriteteve për të shtypur ndjenjat nacionaliste-lokale, shumë njerëz do të ngurrojnë në zbatimin e tyre. Një mbledhje e Lidhjes Socialiste të Kosovës la shtegun hapur për akuza të pazakonta të paaftësisë dhe korrupsionit në jetën publike lokale. Deklarata zyrtare
2. Fadil Hoxha përmendi në një vizitë në Prizren, më 29 maj, disa

nga temat e mësipërme. Ai tha se situata në Kosovë ishte ende “e komplikuar”. Kishte ardhur momenti për veprime praktike dhe jo për mbledhje të gjata të lodhshme për të vendosur për kursin e saj. Më shumë aktivitet nevojitej në mesin e të rinjve, veçanërisht në fshatra ku sjellja nacionaliste kishte hapësirën më të madhe (veçanërisht, pa dyshim pas vendimit për të mbyllur Universitetin më herët).
3. Në një intervistë të gjatë të raportuar në gazetën “Politika” më 1 qershor, Dragoslav Marković i përsëriti këto vërejtje. “Fakt është se puna ideologjike me të rinjtë ka qenë e pamjaftueshme, e varfëruar dhe e stereotipizuar. Kjo ka pasoja me ndikim të gjerë. Është punuar me të rinjtë në Kosovë “por fatkeqësisht nuk është punuar nga ana jonë”. Parimi i centralizmit demokratik nganjëherë është keqinterpretuar plotësisht në Jugosllavi, tha Marković. “Ne pranojmë direktivat por nuk marrim pjesë sa duhet në procesin e marrjes së vendimeve. Rezultatet janë të dukshme - mospërputhje në zbatimin e tyre”. Duhet kohë e konsiderueshme që situata në Kosovë të stabilizohet; meqenëse përgatitjet për aktivitet kundërrivolucionar kanë ndodhur për një kohë të gjatë, po kështu në mënyrë korrespondouese nevojitet një kohë e gjatë për rikthimin e situatës. Pa dyshim ka pasur forca në Kosovë të cilat ishin në gjendje dhe të gatshme të zgjidhnin fitoren e vetëmënxhimit socialist (e panevojshme të thuhet, vlen të përmendet se nuk ka nevojë për ta theksuar këtë). Njerëzit nuk duhet të jenë të padurueshëm me komunistët kosovarë të cilët duhej të bënin betejën kryesore. Lidhja Socialiste e Kosovës
4. Disa nga personat përgjegjës për zhvillimin e betejës kryesore shprehën pakënaqësi për punën e tyre gjërë më sot kur më 1 qershor u mbledh Konferenca Krahinore e Lidhjes Socialiste të Kosovës, për të shqyrtuar situatën e vitit të kaluar dhe për t'u përgatitur për vitin tjetër si dhe për të konfirmuar Azem Vllasin-kryetar. Megjithatë, mbledhja ishte kryesisht e paharrueshme për akuzat e ngritura në të nga delegatë të ndryshëm për shpërdorim të detyrës dhe korrupsion. Siç raportohet në gazetën Politika, u bënë akuza, ndërmjet të tjerash, se fondet zyrtare janë shpërdorur për qëllime private, se ekzistonin ryshfeti dhe nepotizmi, se janë organizuar udhëtime të shtrenjta të panevojshme me shpenzimet publike, se makinat zyrtare janë marrë për përdorim privat, e kështu me radhë. Kryetari i Shoqatës së Veteranëve të Kosovës, tha se akuza të ngjashme në të kaluarën “janë hedhur poshtë në disa drejtime si kritikë-nxitëse dhe për konservatizëm”.
5. Për sa i përket masave për trajtimin e problemeve politike në Krahinë, anëtar i Kryesisë së Lidhjes Socialiste, Jusuf Kelmendi, tha se duhet të ndalohen aktivitetet që ngjajnë si “forume”. Ka pasur diskutime dhe një mal me letra të pafundme, të pavlera dhe

abstrakte. Nevojitej veprimi praktik. Një delegat tjetër tha se që më 11 mars ka pasur vetëm një (!) mbledhje aktive në të cilën shumë pak është vendosur në drejtim të veprimit, përveç katër mbledhjeve për të studiuar një raport mbi aktivitetin e vitit të kaluar.
6. Nisur nga konstatimet në raportet e shtypit, edhe kjo mbledhje nuk arriti të dalë me një plan të thellë. Sidoqoftë, u theksua se çdo përpjekje për të shtrënguar serbët dhe malazezët që të largohen nga Kosova duhet trajtuar me ashpërsi dhe se duhet të analizohet çdo rast emigrimi për të parë nëse është bërë presion. Situata lokale
7. Këto shprehje të ndryshme të shqetësimit zyrtar janë përforcuar nga qarkullimi i vazhdueshëm i lajmeve mbi situatën lokale së cilës iu referua Terence Clark në letrën e tij të datës 17 maj drejtuar Alan Montgomery, paragrafi 15. Raportet e mbledhjeve të komiteteve krahinore të LKJ-së në Ferizaj dhe Istog e bënë të qartë se trazirat vazhdonin dhe se përpjekjet për trajtimin e tyre nuk po shkonin mirë. Kështu, në Ferizaj vazhdonin hapat intensive të LKJ-së “për t'i hequr maskën forcave armike”, por “heshtja dhe oportunizmi” ishin ende mbizotëruese; ishin shkruar parulla dhe ishin ftuar njerëzit për t'u bashkuar me demonstratat ose ishte bojkotuar mësimi. Më e rëndë kjo situatë paraqitej në një shkollë të mesme, në një qendër shëndetësore publike, në fabrikë veglash dhe punimesh druri si dhe në disa shkolla fillore. Drejtori i shkollës së mesme arriti deri aty sa tha se 80% e kuadrove nuk kishin kualifikimin e duhur për punën që bënin. Programi shkollor ishte “i ngarkuar me historicizëm, gjë që e ka lehtësuar detyrën e mësuesve që të shprehnin sjellje nacionaliste”.
8. Më 31 maj gazeta “Borba” sulmoi ashpërsisht Komitetin Krahinor të LKJ-së të Istogut për neglizhencë në trajtimin e trazirave të rifilluara aty. Në Istog demonstratat ishin zhvilluar më 30 prill, pothuajse një muaj pas demonstratave kryesore tjetërkund në Kosovë; gazeta “Borba” pretendoi se përgatitjet për këto demonstrata ishin të njohura publikisht. Studentët kishin krijuar parulla, ndërsa aktivistët e Lidhjes Socialiste ishin sulmuar me gurë nga njerëz lokalë. Megjithatë pas demonstratave nuk u ngrit asnjë akuzë penale. Një raport i përgatitur për mbledhjen e LKJ-së të datës 20 maj thoshte se policia ishte çorganizuar. “Një numër forcash policore thjesht nuk dëshironin të ndërhnin kundër demonstruesve”. Një njësi policore nga Peja ishte e domosdoshme të kërkohej për të ndërhyrë para se të shpërndaheshin demonstruesit. Një raport i gazetës “Politika” që bënte fjalë për të njëjtën mbledhje përfshinte një mori detajesh të vogla shqetësuese dhe demaskuese. Një shembull i tillë është: Kryetari i Komitetit Krahinor tha se dy demonstrues të plagosur kishin kapërcyer radhën për vende në një qendër rehabilitimi, ishin larguar por ishin kthyer dy ditë më pas. Pas kritikave mbi mënyrën se si

udhëheqësit lokalë i kishin trajtuar çështjet kohët e fundit, gazeta “Borba” tha: “Nuk mund të kërkohej dallimi ideologjiko-politik në bazë nëse në nivelet e larta duhet të lihet i paprekur”.
9. Sidoqoftë, spastrimi kishte vazhduar. Gazeta “Politika” raportoi se midis datave 11 mars (!) dhe 20 maj, 440 njerëz ishin përjashtuar nga Partia, dhe pothuajse çdo ditë kishte raportime dëbimesh të reja apo sanksionesh të tjera. Përshkrimi i gazetës “Politika” mbi mbledhjen e Istogut përmendte se një mësues malazez ishte dënuar me 12 vjet burgim për “aktivitet armiqësor nga pozita neoinformozyrtare”. Ky dënim duket jashtëzakonisht i rëndë. Gazeta “Politika” komentoi në mënyrë kritike se ndërkohë që në raste të tjera nuk ishte dhënë një vendim i tillë, këtu ishte pikërisht vendimi që ai mësues meritonte. Nuk kemi informacione të tjera për këtë pikë. Ndërkohë, Universiteti i Prishtinës është rihapur për periudhën e provimeve.
10. Gazetat “NIN”, “Ilustrovana Politika”, “Duga” dhe padyshim artikuj dhe periodikë të tjerë që ne nuk i monitorojmë, i janë futur punës me shumë zell dhe po publikojnë një sasi të tërë informacionesh për rastet individuale shqetësimi apo keqtrajtimi. Kështu, gazeta “Duga” kishte një artikull të gjatë për serbët të cilët pretendonin se ishin detyruar të linin tokat dhe shtëpitë e tyre. Gazeta “NIN” raportoi se disa serbë kishin gjetur pemët e tyre frutore të prera dhe po kështu gazeta “Ilustrovana Politika”, ndoqi po të njëjtën histori plotësisht. Në këtë drejtim, akuza e sekretariatit të Seksionit të Informacionit në Kosovë se revistat nacionaliste të Beogradit kishin qenë “subjektive, negative dhe sensacionale” në raportimin e tyre të ngjarjeve në Kosovë (shih gjithashtu letrën e Terence Clark përmendur më lart, paragrafi 9) u hodh poshtë me vendosmëri nga Konferenca e Kosovës; me të vërtetë vetë Seksioni ishte paralajmëruar për mungesë vigilance! (Meqë ra fjala, lidhur me fuqinë e saj për të mbuluar çështjet e Kosovës, qarkullimi i gazetës “NIN” ka arritur tashmë 200,000 kopje në javë dhe po i kushtohet vëmendje edhe prodhimit të kësaj gazete në shkrimin romak). Konkluzion
11. Masa e lajmeve dhe analizave që po shfaqen në shtyp për Kosovën padyshim bën që njeriu të pyesë se çfarë zgjidhje mund të gjendet për t'u marrë me armiqësitë e thella dhe të dukshme nacionaliste që kanë inkurajuar vitet e vetëkënaqësisë zyrtare. Më e pakta, autoritetet qendrore kanë nxjerrë një mësim të dhimbshëm duke lejuar Kosovën që të ndjekë njëkohësisht politikat e decentralizimit dhe autonomisë lokale dhe kontrollin e gjithanshëm të lajmeve.
I Juaji
Charles Crawford
Oficer Informacioni
Për dijeni: P Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit, FCO
P Rosling Esq,
HMC-G, ZAGREB



-47-
Për përdorim të kufizuar

A. E. Montgomery Esq
Ambasada britanike
Beograd
10 qershor 1981
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
I nderuar Alan,

Kosova: situata e brendshme politike

1. Siç e kam raportuar në letrën time të datës 27 maj, gjithnjë e më shumë çështje po dalin në shtyp lidhur me përgjegjësinë politike për gjendjen aktuale në Kosovë. Në veçanti, vazhdon të shfaqet kërkesa e përsëritur e Joze Smoles që të publikohet vlerësimi i Kardeljit i vitit 1977. Çështja u ngrit nga gazetarët jugosllavë në një konferencë për shtyp të dhënë nga Azem Vllasi, kryetar i Lidhjes Socialiste të Kosovës, më 5 qershor; gjithashtu gazeta “NIN” këtë javë ka tërhequr përsëri vëmendjen ndaj saj, duke botuar një intervistë me Mitja Ribiciq nën titullin: “Çfarë tha Kardelj”.

2. Ribiciq, kryetar i Aleancës Socialiste të Sllovenisë, ka qenë subjekt i një sërë intervistash gjatë muajve të fundit kryesisht sepse, unë dyshoj, ai e ka zakon të shprehë mendimin e tij në një gjuhë të thjeshtë, gjë për të cilin ai është kërkuar nga kolegët e tij të dëshmojë kur herë pas here e kalon masën. Me këtë rast, gazeta “NIN”, pyeti ndër të tjera nëse ai mund të jepte thelbin e asaj që Kardelj ka thënë për aktivin politik në Kosovë në vitin 1977. Përgjigja e tij ngre pyetje të tjera të vështira.

3. Ribiciq tha se edhe një shikim i shpejtë në temën e këtij diskutimi tregon se “nuk duhet të ishim çuditur për atë që ndodhi gjatë muajve të fundit në Kosovë”. Ai besonte se Kardelj, “megjithëse pati përpjekje për ta çorientuar atë”, ka dhënë një vlerësim që edhe në ditët e sotme ishte jashtëzakonisht interesant dhe paralajmëronte për kundërrevolucionin që kishte ndodhur që atëherë. Kardelj kishte thënë se ishte e vështirë të bihej dakord që situata politike ishte aq “e mirë” sa ata thonin dhe se gjithsesi nuk do të zgjaste nëse “ata” vazhdonin siç po bënin, pra nëse ata vepronin pa pyetur për interesat më të gjera të të gjithëve dhe kërkonin zgjidhje për problemet e Kosovës vetëm përmes kërkesave për më shumë para ose, sikurse u shpreh Ribiciq, “përmes një marrëdhënieje parazitare me ata që garantonin fondet”.

4. Kardelj paralajmëroi gjithashtu për rreziqet e politikës në drejtim të fshatrave, gjë që rezultoi në migrimin e një numri të madh të rinjsh jashtë vendit ose në qytete për të studiuar apo punuar, duke shkaktuar probleme serioze sociale dhe politike.

5. Kardelj e pa nacionalizmin shqiptar pjesërisht si rezultat i nacionalizmit më të hershëm serb por vlerësonte se shqiptarët, si shumicë, kishin tani përgjegjësi për të drejta të barabarta të nacionaliteteve të tjera. Kishte arsye mjaft objektive për nacionalizmin shqiptar në prapambetjen e Kosovës dhe traditat e vjetruara, që mund të

bëheshin shkak për kundërrevolucion pa krijuar interesa të veçanta për nacionalitetin shqiptar.

6. Në fund, Kardelj pranoi se ekzistonte faktori i emigrantëve shqiptarë, por duket se i hoqi nga mendja duke menduar se nuk ishin në gjendje që të dëmtonin Jugosllavinë. Ai foli gjithashtu për disa manifestime tfohjeje të udhëheqjes në Kosovë nga populli, për privilegje...

7. Me pak fjalë, Ribciq, i cili ka ose kujtesë të jashtëzakonshme ose kopje të asaj çfarë tha Kardelj (unë dyshoj për këtë të fundit), thoshte se Kardelj kishte parë me saktësi se nga frynte era në Kosovë pikërisht katër vjet më parë. Ajo çfarë Ribciq nuk tha, por çështja është lënë qartazi pezull, është se përse nuk është bërë asgjë për të ndrequr tendencën e dëmshme nga njerëz të cilët, përveç Bakallit, ishin në pushtet atëherë dhe janë ende sot. Vllasi tha në konferencën e tij për shtyp që ai personalisht nuk e besonte se kishte përpjekjet të qëllimshme për të zhdukur regjistrimin e diskutimit të Kardelj, por është e qartë se gazetarët dhe të tjerët pikërisht këtë mendonin. Kushdo mund të supozojë se autoritetet nuk mendojnë se do të ishte në interesat e tyre që të zbulonin çdo gjë aktualisht por sipas mendimit tim ata do të duhet që herët a vonë të nxjerrin të vërtetën, nëse vazhdon presioni i tanishëm për të kërkuar shpjegim.

8. Me artikullin e saj të përditshëm për Kosovën, gazeta “Politika” e datës 9 qershor, të cilën Charles Crawford është duke e raportuar në hollësi, ndihmon për të ndjekur presionin me një seri pyetjesh të mprehta lidhur me përgjegjësinë për situatën. Duke renditur mangësitë e panumërta të Universitetit të Prishtinës, gazeta “Politika” pyet se çfarë kanë bërë për to 4,800 anëtarët e LK-së në radhët e studentëve dhe stafit mësimdhënës. Organizimet e LK-së të Universitetit janë të lidhura me Konferencën e LK-së të qytetit, e cila thekson gazeta “Politika”, ende nuk e ka vlerësuar situatën në Universitet, përveç disa kritikave verbale. Pyetja e papritur është - pse jo? Gazeta “Politika” vazhdon më tej duke theksuar se shumica e stafit mësimdhënës ishte emëruar “pa dijeninë dhe influencën e fakulteteve”. Askush nuk pyet pse, thotë gazeta “Politika”, e madje as Konferenca e LK-së së Prishtinës, e cila ka përgjegjësi të konsiderueshme për situatën në Universitet. Studentët mbarojnë universitetin pa ditur gjënë e parë mbi marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë dhe Federatën. Për çfarë është stafi mësimdhënës? – pyet gazeta “Politika”. Më seriozisht, gazeta “Politika” pyet se si ka ndodhur që kjo marrëdhënie është hequr nga dokumente të ndryshme zyrtare, për të cilat organet e Këshillit Ekzekutiv të Kosovës janë përgjegjëse dhe askush nuk është kërkuar ende të përgjigjet për këtë apo është përjashtuar nga LKJ-së.

9. Objektivi kryesor i gazetës “Politika” është universiteti, ku më në fund dhe haptazi me shumë ngurrim, rektori dhe dy zëvendësrektorët paraqitën dorëheqjet e tyre javën e kaluar, të cilat u pranuan nga Këshilli i Universitetit në mbledhjen e tij të datës 9 qershor. Universiteti, vëren gazeta “Politika”, i detyrohet një

përgjigje të gjithë atyre punëtorëve të cilët kanë investuar në të. Po kështu, Konferenca e LK-së së Prishtinës u detyrohet një përgjigje. Mbetet për t’u parë nëse do të ketë ndonjë përgjigje në të ardhmen, por të krijohet përshtypja se në qarqet politike po kuptohet shumë ngadalë se nuk është më e mundur që njerëzit në poste të larta të shmangen nga përgjegjësia për gabimet e tyre, qoftë të veprimeve a mosveprimeve. Një zëvendëssekretar i Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Kosovës dha dorëheqjen javën e kaluar. Duket e sigurt se drejtues të tjerë do të marrin tatëpjetën.

I Juaji, T. J. Clark

P Rennie Esq; P. Rosling Esq
Departamenti i Kërkimit, Zagreb

-48-
Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Beograd
10 qershor 1981
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
I nderuar Charles,

Kosova: një kronologji e ngjarjeve

1. Vazhdimisht ju kemi informuar në mënyrë mjaft të plotë për ngjarjet në Kosovë, shpresoj, pa ju mbingarkuar me shumë detaje. Aq shumë ngjarje janë duke ndodhur çdo ditë në Krahinë dhe aq shumë informacione të reja filtrohen për ngjarjet e kaluara sa kemi vendosur që të mbajmë një kronologji të tyre me qëllim që të mos humbasim ndjekjen e fillit kryesor.

2. Gazeta “Politika” dhe disa gazeta të tjera kishin të njëjtën ide. Gazeta “Politika” sapo ka publikuar kronologjinë e ngjarjeve në formë libri (një kopje e të cilit i është dërguar vetëm Departamentit të Kërkimit). Bashkangjitur po ju dërgoj kronologjinë e bërë nga Jon Ward nga data 11 mars deri më 31 maj, e cila mund të jetë e dobishme për ju. Ne do të vazhdojmë të mbajmë kronologjinë e ngjarjeve, nëse ato vazhdojnë të ndodhin me ritmin aktual.

3. Vlen të theksojmë dy pika që dalin nga një kronologji e tillë. Së pari, ka pasur qartazi shumë më tepër punëtorë të përfshirë në demonstratat e prillit sesa ishim drejtuar për të besuar. Për më tepër, ka qenë shumë e vështirë

për të bindur personat e përfshirë që të pranonin gabimet e tyre. Kjo është shqetësuese për autoritetet për të cilat “punëtorët” kanë një domethënie të veçantë ideologjike dhe shihen si tejet të pastër. Së dyti, aktiviteti antisërbo-malazez ka ndodhur gjithashtu në shkallë më të gjerë sesa autoritetet u përgatitën të pranonin fillimisht. Kjo thyerje e “vëllazërisë dhe unitetit” është veçanërisht shqetësuese për autoritetet meqenëse vë në dyshim efektivitetin e një prej pikave kryesore të politikës së brendshme të Titos. Më shumë në këtë çështje do ju njoftoj së shpejti.

I Juaji,
T. J. Clark
Për dijeni: P. Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit, FCO

-49-
Konfidenciale

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Beograd
10 qershor 1981
EESD
FCO
I nderuar Charles,

Kosova: situata e brendshme dhe universiteti i Prishtinës

1. Kjo javë ka kaluar përsëri me diskutime pa rezultat për situatën në Kosovë në një seancë të Kuvendit të Kosovës dhe një nga Konferencat Krahinore të LKJ-së së Prishtinës. Nuk ka shenja se autoritetet po ia dalin “për të diferencuar” më me efektivitet dhe mungesa e progresit në këtë drejtim në Universitetin e Prishtinës në veçanti ka shkaktuar kritika shumë të ashpra nga shtypi. Çdo ditë publikohen më shumë detajeve të incidenteve të mëparshme nacionaliste në Kosovë, duke theksuar në mënyrë dramatike shtrirjen e dallueshme të fshehjes zyrtare që ka ndodhur gjatë një periudhe të gjatë para demonstratave të fundit. Kuvendi i Kosovës dhe Konferenca Krahinore e Prishtinës

2. Megjithëse mbledhja e Kuvendit të Kosovës, më 3 qershor, mund të mos ketë arritur shumë sukses në propozimin e zgjidhjeve, ajo prodhoi një masë informacionesh mbi aktivitetin e vazhdueshëm nationalist në Krahinë. Një raport i përgatitur për Kuvendin mbi situatën politike midis 24 prillit dhe fundit të majit dha një përshkrim shqetësues të aktivitetit të përhapur, megjithëse në shkallë të vogël, dhe armiqësor: fletushka dhe parulla që lavdëronin

Shqipërinë dhe kërkonin lirinë dhe u shfaqën kërkesat për lirinë e të burgosurve politikë; varret serbe ishin dhunuar dhe një kopsht frutor serb ishte shkatërruar; u raportuan dy greva; bojkotet e shkollave të mesme ishin të shumta; gjithashtu u bënë përpjekje të mëtejshme për të organizuar demonstrata (megjithëse konfiskimi i aparaturave të fotokopjeve dhe makinave të shkrimit kishin ndihmuar për të penguar një lëvizje të tillë). U bënë thirrje për dorëheqje në Universitetin e Prishtinës, ku edhe kishin shpërthyer trazirat kryesore. Një delegat u ankua se spastrimi po kryhet nga vegjelia në nivelet më të larta dhe jo anasjelltas.

3. Siç raportoi së paku gazeta “Politika”, mbledhja e Konferencës Krahinore të LKJ-së së Prishtinës, më 6 qershor, ishte një çështje shumë më pak interesante, për të cilën u përsëritën ankesat e përbashkëta deri më tani për dobësi në LKJ-së. Asllan Fazlija, kryetar i Konferencës, tërhoqi vëmendjen në “një klasë dhe strukturë të luftës revolucionare të papërshtatshme, organizim të pamjaftueshëm, veçanërisht në zonat më të mëdha ekonomike dhe në Universitet, si dhe nivel të ulët ideologjik dhe mungesë gatishmërie për anëtarësim”. Mospërputhja dhe njëanshmëria në zbatimin praktik nga LKJ-ja të politikave në lidhje me barazinë kombëtare, “veçanërisht në politikën e punësimit dhe kuadrove”, kishte ndihmuar në krijimin e ndjenjës së pasigurisë në mesin e serbëve dhe malazezëve. Tashmë kishte më shumë kërkesa prej tyre për t’u larguar nga Prishtina. “Eksodi i kuadrove të nevojshëm për ekonominë e Prishtinës dhe Kosovës ishte veçanërisht i dëmshëm” (Kemi në plan të raportojmë më vete për problemin e emigrimit të joshqiptarëve). Më 8 qershor, gazeta “Politika” e bëri të qartë se kjo mbledhje ishte e pasuksesshme. Seanca prej tetë orësh ishte marrë me argumente të vjetra dhe jo me paraqitjen e këndvështrimit vetëkritik të përgjegjësive kolektive dhe individuale të anëtarëve, thuhej në këtë artikull. Këto ngjarje kishin rrënjë të thella. Ajo që u përmend mjaft shpesh, por që nuk u shpjegua siç duhet, ishte kalimi në heshtje i propagandës nga Shqipëria dhe politikat e kuadrove para demonstratave.

Universiteti i Prishtinës

4. Ankesa për një kohë të gjatë se



anëtarët më të lartë të Universitetit të Prishtinës i janë shmangur përgjegjësisë për trazirat e krijuara, e që u përsërit me forcë në Kuvendin e Kosovës, më në fund dha rezultate. Më 1 qershor, u njoftua ofrimi i dorëheqjes i një prej zëvendësrektorëve; ndërkohë më 5 qershor u njoftua se rektori dhe një tjetër zëvendësrektor kishin ofruar dorëheqjen e tyre. Rektori u shpreh se po jepte dorëheqjen “për arsye të ndërgjegjes dhe ndjenjës së përgjegjësisë për situatën e përgjithshme në Universitet dhe në lidhje me të”.

5. Sidoqoftë, këto gjeeste vetëdiferencimi nuk mjaftonin për të kënaqur gazetën “Politika”, e cila më 9 qershor publikoi një artikull të gjatë sulmues dhe depërtues mbi mënyrën se si ishte drejtuar Universiteti. Konkuzioni i artikullit ishte se informacionet për Universitetin dhe menaxhimin e tij ishin të paqarta ose të pakuptueshme. Vlerësimet për numrin e studentëve, për shembull, varionin nga 48,000 në 54,000 dhe në një mbledhje të vetë Rektoratit javën e kaluar ishte vënë(në mënyrë të paqartë) në dukje se “asnjë nuk e di me saktësi sa është numri i studentëve, përveç gjatë rekrutimit kur zyra e ushtrisë gjen listat e dyfishta”. Studentët diplomoheshin ndërkohë që nuk dinin asgjë për statusin e Kosovës në Serbi dhe në Federatën Jugosllave, për progresin social në Krahinë, apo për pozitën e Jugosllavisë në botë (kjo ndodhte pasi disa nga studentët kishin më shumë se nëntë vjet në Universitet!). Megjithëse kishte pretendime se doktoratat ishin marrë “menjëherë” dhe se, sado të kushtonte, po krijoheshin kuadro shqiptarë pa formimin e duhur shkencor, askush nuk i kushtoi vëmendje. “Për çfarë ishin duke i përgatitur profesorët studentët e tyre? A ishin duke i ndarë ata gradualisht nga Serbia dhe Jugosllavia duke lartësuar historinë shqiptare, duke evokuar romanticizmin dhe “faktet historike” të sapo zbuluara për historinë e Ballkanit? Vështirë të besohet se këta profesorë vepronin nga injoranca”.

6. Duke i renditur këto defekte në punët e Universitetit, gazeta “Politika”, u shpreh se heshtja ishte gjithashtu faji i institucioneve dhe agjencive krahinore të cilat i kishin bekuar politikat e këtij Universiteti. Kështu për shembull, kryetari i Kuvendit të Kosovës kishte thënë se ata kishin mësuar për krijimin e Universitetit vetëm nga gazetatat, duke shtuar se Kuvendi nuk ishte shprehur në zgjedhjen e organeve të Universitetit me gjithë faktin se vetë Kuvendi e kishte miratuar ligjin për rregullimin e tyre. Në Konferencën Krahinore të Prishtinës ishte thënë se dekanët dhe zëvendësdekanët ishin emëruar “përtej dijenisë dhe influencës së fakulteteve”. Por lind pyetja, nga kush u emëruan atëherë? “Komunistët e pranishëm, fëmijët e të cilëve ishin në Universitet, nuk kërkuan asnjë shpjegim dhe as nuk u dha ndonjë i tillë”. Stema e Serbisë ishte hequr nga dëftesat e shkollave fillore dhe simboli që tregonte pozitën e Kosovës brenda Jugosllavisë ishte zhdukur nga dyert e institucioneve krahinore, vendime këto që duhet të jenë miratuar nga Këshilli



Ekzekutiv i Kuvendit të Kosovës. 7. Është thënë në shumë raste se “procesi i diferencimit” në Universitet kishte ecur veçanërisht ngadalë. Gazeta “Politika” raportoi se takimet e LKJ-së nuk ishin në gjendje të fitonin kuorumin e nevojshëm meqenëse studentët tani ishin në shtëpi. Në të vërtetë, Këshilli i Universitetit ishte vonuar në zhvillimin e mbledhjeve të tij për shkak të pamundësisë për të krijuar kuorumin e duhur, megjithëse takimi i radhës pritej të paraqiste një debat mbi përgjegjësinë dhe mënyrën se si Universiteti ishte bërë “një shtat i ngrohtë i nacionalizmit”. Punëtorëve dhe njerëzve të tjerë si në Kosovë dhe në Jugosllavi në përgjithësi të cilët kishin investuar shuma të mëdha për qëllime arsimimi u duhej dhënë një përgjigje për këtë pyetje, tha gazeta “Politika”, dhe Konferenca Krahinore e Prishtinës, anëtarët e së cilës ishin gjithashtu komunistë nga Universiteti, duhej të jepnin një të tillë. “Megjithatë, fjalët e censurës të shprehura me zë të lartë dhe të përditshme, nuk mund të zëvendësojnë veprimin konkret. Shumë komunistë të Universitetit, si nga radhët e profesorëve dhe të studentëve, dështuan në këtë provim”.

8. Megjithatë, një veprim konkret u shënua më 6 qershor. Që prej vitit të ardhshëm akademik e në vazhdim, komunitetet lokale ishin ngarkuar me përgjegjësinë për të vendosur se kush nga studentët duhet të kishte vende në konviktet për studentë, por gjithsesi, asnjë student që banonte 30-40 kilometra larg Prishtinës nuk do të përfitonte vend në konvikt meqenëse transporti në Prishtinë ishte i mirë organizuar. Kështu, 600 vende do të lireshin rezervë për studentët që vinin nga vendet e tjera në Jugosllavi. Manifestimet nacionaliste 9. Vlen të përmenden disa nga identitetet që shtypi i ka raportuar kohët e fundit për të treguar se çfarë lloj sjelljesh janë llogaritur për të shkaktuar shqetësime ose pakënaqësi. Kështu, dy vjet më parë në një turne ballkanik volejbolli në Prishtinë, ekipi i femrave jugosllave, me sa duket “shpërtheu në lot për shkak të fishkëllimave dhe vërshtëllimave të ashpra të spektatorëve ndërkohë

që shqiptarët i gëzoheshin këtyre ‘pritjeve miqësore’ ”. Profesorët ishin duartrokitur sepse kishin lavdëruar Enver Hoxhën dhe denigruar Jugosllavinë në leksionet e tyre. Për disa punë jepej pagesë ekstra për njohjen e gjuhës shqipe, por jo për njohjen e gjuhës serbe. Fotoja e Titos ishte hequr nga faqja e zakonshme në disa libra leximi për klasën e parë në shkollat për të vegjlit. Shenjat e rrugëve me emrat e heronjve kombëtarë si dhe bustet dhe statujat e tyre ishin vjedhur. Qeleshe të bardha shqiptare ishin vënë më parë dhe vazhdonin të viheshin “në mënyrë provokative” (me sa duket nga të rinj të cilit nuk do pranonin t’i mbanin veshur). Nga ana tjetër, dyqanet shqiptare gjetkë në Jugosllavi u bojkotuan nga publiku gjatë javëve të fundit. Shumë prej këtyre rasteve dhe të tjera si këto kanë shijen e veprave të këqija spontane dhe jo të “aktivitetit armiqësor” të bashkërenduar, megjithëse është e rëndësishme të kuptohet pikërisht se sa dëshpërues ka qenë dështimi i nxitjeve standarde për “vëllazëri dhe unitet” në Kosovë krahasuar me bashkekzistencën në dukje të suksesshme të nacionaliteteve të ndryshme (megjithëse në mënyrë të konsiderueshme më të sofistikuar) në Vojvodinë.

Komente 10. Tabloja mbetet e zymtë, me gjithë kërkesën e Azem Vllasit në një konferencë për shtyp që ai mbajti për gazetarët jugosllavë sipas të cilit shtypi “injekton njëfarë optimizmi” në raportimin e tyre. “Me të vërtetë, në disa zona njeriu fiton përshtypjen se situata është e pashpresë, por duke e parë përballë në tërësinë e vet, tabloja është optimiste”. Përshtkrimi i problemeve të kësaj jave në Universitetin e bujshëm zor se nxit një këndvështrim të tillë. Përshtypja e krijuar flet për një institucion të zvarritur, i cili prodhon çdo vit një numër të madh të diplomuarish të kualifikuar jo siç duhet (në mos injorantë) dhe i administruar në mënyrë joefikase në shkallë të gjerë nga shqiptarë të vrazhdë dhe evazivë. Përpjekjet e bëra deri më sot për t’u ndeshur me këtë monstër jashtëzakonisht të shtrenjtë “të ngritur përtej kërkesave të punës që lidhet me të,

gjigante në madhësinë e saj, por të varfëruar në potencialin e kuadrove të vet” (siç e quajti gazeta “Politika”) ka dështuar qartazi. Në Kosovë në përgjithësi dhe në Universitet në veçanti, pulat e vetmenaxhimit janë kthyer në kotecet e tyre të decentralizuara.

I Juaji, Charles Crawford
Oficer Informacioni
Për dijeni: P. Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit, FCO

-50-
Për përdorim të kufizuar

Fm Beograd 1510312, qershor '81
(Kopje origjinale)
To routine FCO
Tel. nr. 98, datë 15 qershor 1981
Përsëritur për Zagreb
Nr. ynë i telegramit 93

Kosova

1. Sekretariati federal i Marrëdhënieve me Jashtë më ka informuar zyrtarisht se turistët e huaj nuk do të lejohen të vizitojnë Kosovën deri në një njoftim tjetër. Në lidhje me biznesmenët çështja është si në rastin e turistëve.

[Ky telegram nuk është përcjellë]

CLARK
ENU 015/3
17 qershor 1981
EESD
CONS D
NEWS D

-51-
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit

Londër SW1A 2AH
T. J. Crarke Esq
Beograd
15 qershor 1981

Kosova: situata e brendshme politike

1. Ju falënderoj shumë për letrën tuaj të datës 10 qershor, ku raportoni komente interesante të Ribiciç në lidhje me “atë që ka thënë Kardelj”. Mesazhi që përcillet me zë të lartë dhe qartë është se i tërë episodi i Kosovës po trajtohet me një shkallë të habitshme transparence; gjithashtu çdokush

pyet veten se çfarë efektesh (plotësisht të ndara nga implikimet e vetë ngjarjeve të Kosovës) do të kenë këto ngjarje dhe jehona e tyre për çështje kaq të gjera si liria e shtypit dhe llogaridhënia e zyrtarëve dhe ministrave. 2. Më lejoni t’ju falënderoj ju dhe anëtarët e tjerë të Misionit për raportimin gjithëpërfshirës mbi problemin e Kosovës. Ka interes të konsiderueshëm këtu për këto ngjarje dhe jemi ndjerë në një pozitë të mirë për të hartuar përmbledhje raportimesh etj., falë informacioneve shumë të detajuara dhe analizave të matura që keni dërguar ju. 16 qershor 1981
A. E. Montgomery
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Për dijeni: P. Rosling Esq, Zagreb
P. Rennie Esq, Departamenti i Kërkimit

-52-
Për përdorim të kufizuar

Fm Beograd 120800z, qershor '81
(Kopje origjinale)
Informacion rutinë për FCO
Tel. nr. 93, datë 12 qershor 1981
16 qershor 1981
Nr. i telegramit tuaj 74

Kosova

1. Nuk është bërë ende e mundur të merret vija e qartë zyrtare për vizitat e turistëve në Kosovë. E kam ngritur këtë çështje me Vrhovec, më 9 qershor, por ai nuk kishte informacion për këtë dhe ia la Departamentit që të na jepte një përgjigje. Sondazhet nga stafi im me protokoll tregojnë se turistët nuk e përsëris nuk, duhet të shkojnë në Kosovë. Biznesmenët duhet të bëjnë kërkesë përmes nesh për leje, e cila zakonisht do të jepet me kusht që firmat pritëse të jenë të gatshme për t’i takuar dhe të kujdesen për ta. 2. Sugjeroj që përgjigjet e pyetjeve të jepen përmes kësaj këshille jozyrtare deri kur të marrim përgjigjen e premtuar.

[Ky telegram nuk është përcjellë]
Bolland
MIMIMUM
EESD
CONS. D
NEWS. D



Kosova U19 pëson nga Sllovenia, përfundon ëndrra evropiane

PRISHTINË, 26 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës U19 në futboll ka pësuar humbje në udhëtim të Sllovenia U19 (2-0) në kuadër të “Elite Round” për kualifikim në

Kampionatin Evropian 2024. Pas kësaj humbjeje, Kosova mbetet jashtë Kampionatit Evropian që do të mbahet gjatë kësaj vere. Çuber Potočnik dhe Florian

realizuan për rezultatin final 2-0. Kështu, pas tri ndeshjeve të luajtura, Kosova e mbyll grupin me një fitore dhe dy humbje. Fitoren e mori ndaj Austrisë 1-0, pësoi 2-1 nga

Spanja dhe nga Sllovenia. Në grupin 1, kryeson Spanja me shtatë pikë, e dyta është Sllovenia me katër dhe nga tri pikë kanë Kosova e Austria, në pozitat tre dhe katër.



Sot fillon Liga Unike, marrin pjesë katër skuadra nga Kosova dhe katër nga Shqipëria

“Epoka e re”

Vlorë, 26 MARS - Liga Unike Lajthiza do të mbahet për herë të parë në qytetin e bukur dhe historik, Vlorë. Nga 27 deri më 31 mars pritet spektakël i basketbollit mbarëshqiptarë, ku përballen katër skuadra nga Kosova dhe katër nga Shqipëria. Në çerekfinale do të përballen Trepça me Kamzën, derisa Tirana Neptun do të përballen me Golden Eagle Yllin, kurse në ditën e dytë çerekfinale do të ndeshen Peja me Teutën e Durrësit dhe Besëlidhja me Sigal Prishtinën. Në gjysmëfinalen e parë do të përballen fituesi i ndeshjes Peja - Teuta me fituesin e ndeshjes Tirana Neptun - Golden Eagle Ylli, kurse në gjysmëfinalen e



dytë do të përballen fituesi i ndeshjes Trepça - Kamza me

fituesin e ndeshjes Besëlidhja - Sigal Prishtina. Të premtën do të

zhvillohen dy ndeshjet gjysmëfinale, kurse të dielën

ORARI

Më 27 mars takohen:
16:00 Trepça-Kamza
19:00 Tirana Neptun-Golden Eagle Ylli

Më 28 mars takohen:
16:00 Peja-Teuta
19:00 Besëlidhja-Sigal Prishtina

Më 29 mars takohen:
16:00 Gjysmëfinalja 1 (Peja/Teuta vs Tirana Neptun-Golden Eagle Ylli)
19:00 Gjysmëfinalja 2 (Trepça-Kamza vs Besëlidhja-Sigal Prishtina)

Më 31 mars takohen:
16:00 Ndeshja për vendin e tretë
19:00 Finalja

është sfida për vendin e tretë dhe finalja. Ndeshjet do të transmetohen në RTSh për Shqipëri dhe Art Motion e Kujtesa për Kosovë.

Shabani shpall listën për dy ndeshjet me Poloninë



PRISHTINË, 26 MARS - Selektori i Përfaqësueses së Kosovës në hendboll, Agron Shabani, ka shpallur të martën listën e lojtarëve në të cilat llogaritet për dy ndeshjet shumë të rëndësishme me Poloninë. Kosova e Polonia takohen në kuadër të fazës kryesore kualifikuese për “Euro 2024”. Ndeshja e parë është më 4 prill nga ora 17:45 në Prishtinë. Ndeshja e dytë zhvillohet më 7 prill në Zielona Gora të Polonisë. Kosova e Polonia janë në Grupin 8, ku bën pjesë edhe Danimarka. Danezet i kanë

fituar të gjitha katër ndeshjet e deritashme dhe tashmë janë kualifikuar në Evropian. Polonia llogaritet favorite ndaj Kosovës. Por vajzat tona do ta japin maksimumin për të shënuar një fitore, që me shumë mundësi do të mjaftonte për kualifikim në Evropian. Kosova pritet të ketë përkrahje të madhe në ndeshjen në Prishtinë, ku synohet të befasohet Polonia. Grumbullimi i Përfaqësueses është më 29 mars në Prishtinë. Deri në ditën e ndeshjes Kombëtarja i ka nga dy stërvitje

në ditë. Selektori Shabani është bazuar në grupin e lojtarëve tashmë të konfirmuara, ndërsa rastin ua ka dhënë edhe disa lojtarëve të reja. Për shkak të obligimeve personale, në këtë grumbullim mungon aloga Fitore Aliu.

LISTA E HENDBOLLISTEVE

Elisa Mulaj, Melisa Mulaj, Mirela Gjirkokaj, Luljeta Esati, Yllka Shatri, Arlinda Hajdari, Albina Rugova, Venera Kafexholli, Arona Krasniqi, Leonora Demaj, Marigona Hajdari, Arlinda Dinarica, Aurora Kryeziu, Suzana Ujkiq, Dafina Mustafa, Elisa Mirdita, Angjelina Krasniqi.

Sylvinho: Luajtëm me zemër dhe jam i trishtuar që nuk fituam apo barazuam

TIRANË, 26 MARS - Trajneri i Shqipërisë, Sylvinho, është shprehur i kënaqur me paraqitjen e kuqezinjve në miqësoren ndaj Suedisë, ani pse rezultati ishte 1-0 për suedezët. Trajneri brazilian ka thënë se Shqipëria luajti me zemër, por që është i trishtuar që nuk barazuam apo fituan. “Lojtarët janë pak në ankth pasi 23 prej tyre do të

shkojnë në Evropian. Ky është momenti për t'i vlerësuar lojtarët. Rezultati është i rëndësishëm, por jo më i rëndësishmi. Bëmë një tjetër paraqitje nga ajo me Kilin. Mund ta kishim merituar fitoren dhe provuam diçka ndryshe për të arritur te goli. Kishim shpejtësinë e Brojës, një penallti që na u mohua, e vështirë kur luan pa

VAR pasi ja si shkojnë gjërat. Shpejtësia e Brojës ishte shumë e rëndësishme. Jam i trishtuar për fatin që nuk fituam apo barazuam. Nuk kam çfarë t'u them lojtarëve për atë që bënë në fushë. Luajtëm me zemër dhe tifozët bënë të ndiheshim si në shtëpi. Duhet t'ua transmetojmë shpirtin dhe zemrën në fushë”, ka thënë Sylvinho.



Alcarazi dhe Sinneri mund të kenë një rivalitet si Federeri me Nadal

Madrid, 26 mars - Tashmë që Roger Federeri është tërhequr nga tenisi, të gjithëve u mungon rivaliteti që ai kishte me Rafael Nadal. Tenisti spanjoll Carlos Alcaraz dhe ai italian Jannik Sinner vazhdojnë ta mbajnë lart flamurin e brezit të ri. Dy tenistët kanë arritur një pjekuri të rëndësishme, që pritet të jetë

rivaliteti i ardhshëm i këtij sporti. Dy tenistët, respektivisht numrat 2 dhe 3 në botë, u përballën për herë të fundit në gjysmëfinalen e Indian Wells (fitoi Alcaraz). Alcaraz, duke folur për rivalitetin me Sinnerin dhe mundësinë që ajo t'i ngajë asaj mes Federerit e Nadalit, ka

thënë: “Fedal? Ata kishin një rivalitet shumë të bukur dhe sfidues në të njëjtën kohë”. “Ajo që mësova prej tyre është se nuk mund të ngelesh kurrë prapa, të dorëzohesh apo të vendosesh. Ju gjithmonë duhet të përmirësoheni, gjithmonë duhet ta ngrini nivelin tuaj. Nuk ka rëndësi nëse mendoni se jeni

në maksimumin tuaj, gjithmonë mund të jepni pak më shumë”, u shpreh Carlos Alcaraz. “Unë shpresoj që me Jannik të kem një rivalitet si ai që kishin ata të dy. Shpresojmë që të dy të kemi një të ardhme të gjatë dhe të bukur përpara nesh në këtë sport. Në këtë mënyrë, shpresoj të jem në gjendje të jap më të



mirën time dhe të vazhdoj të rritem falë rivalitetit me të”, ka shtuar tenisti spanjoll.

Gjermania do të kryejë kontrole kufitare gjatë Kampionatit Evropian

Berlin, 26 mars - Gjermania do të kryejë kontrole kufitare në të gjithë kufijtë e vendit gjatë Kampionatit Evropian të Futbollit në qershor dhe korrik, njoftoi të martën ministrja e Brendshme e Gjermanisë, Nancy Faeser. Faeser tha për gazetën e përditshme “Rheinische Post” se do të kryhen kontrole në të gjithë kufijtë gjermanë gjatë turneut të futbollit “për të qenë në gjendje të mos i lejojmë të futen brenda kriminalët e mundshëm të dhunshëm”. “Kjo është e nevojshme për ta mbrojtur këtë turne të madh sa më mirë që mundemi”, ka thënë Faeser. “Autoritetet janë të vendosura të ofrojnë mbrojtje kundër ekstremistëve islamistë dhe ekstremistëve të tjerë, kundër huliganëve dhe të tjerëve, si dhe t'i sigurojnë rrjetet kundër sulmeve kibernetike”, tha ajo. Komentet e Faeserit vijnë pak ditë pas një sulmi ndaj një salle koncertesh në Moskë, përgjegjësinë



për të cilin e mori një grup i lidhur me Shtetin Islamik. Megjithatë, vendimi për t'i kthyer kontrollet kufitare gjatë turneut të futbollit pritej kohë më parë. Kjo është bërë një praktikë standarde për vendet në zonën e lëvizjes së lirë në Evropë, e njohur si Zona Schengen, gjatë ngjarjeve të mëdha sportive dhe samiteve të mëdha. Gjermania

është duke kryer kontrole kufitare tashmë në lindje me Poloninë dhe në jug me Republikën e Çekisë, Austrinë dhe Zvicrën, për shkak të emigrantëve. Kampionati Evropian fillon më 14 qershor. Gjermania, si nikoqire, e luan ndeshjen hapëse kundër Skocisë në Muni. Finalja e Evropianit do të zhvillohet në Berlin më 14 korrik.

Denveri merr komandën në Perëndim, Atlanta përmbys Bostonin në sekondat e fundit

DENVER, 26 MARS - Kryesuesit e Bostonit u mundën me rezultat 120-118 nga Atlanta, në një ndeshje të ekuilibruar deri në fund. Një përmbysje fantastike e Atlanta, ku u dalluan Hunteri me 24 pikë e Bogdanoviqi me 22 pikë. Për Bostonin, Tatumi realizoi 37 pikë, por që mbetën për statistikë. Ngjit shkallët në renditje skuadra e Dallasit, që mposhti me shifrat 115-105 Utah Jazzin jashtë fushës. Luka Doniqi, protagonist me një “triple double”, autor i 29 pikëve, 12 reboundeve e 13 asistimeve. Në sekondat e fundit



fiton edhe San Antonio, që falë 52 pikëve të dyshes Sochan - Vassell, mundi me rezultat 104-102 Phoenixin. Humbja e dytë radhazi

për clippersat, që në fushën e tyre u mundën me rezultat 133-116 nga Indiana. Për miqtë u dallua Siakam me 31 pikë. Nuk zhgënjen ekipi kampion i Denverit, që mundi me rezultat 128-123 Memphisin, duke ruajtur vendin e parë në Perëndim. Për kampionët u dallua Jokiqi me 29 pikë.

REZULTATET	
Cleveland - Charlotte	115-92
Atlanta - Boston	120-118
New York - Detroit	124-99
Toronto - Brooklyn	88-96
Chicago - Washington	105-107
Houston - Portland	110-92
San Antonio - Phoenix	104-102
Denver - Memphis	128-123
Utah Jazz - Dallas	105-115
Sacramento - Philadelphia	108-96
Clippers - Indiana	116-133

E ardhmja e Nagelsmann te Gjermania vendoset para Evropianit

Trajneri gjerman Julian Nagelsmann dëshiron që e ardhmja e tij afatgjatë të zgjidhet përpara se të nisë Kampionati Evropian i Futbollit. Për trajnerin janë interesuar disa nga klubet e Premier Ligës, ndërkohë që vetë Nagelsmann diskuton një zgjatje të kontratës me kombëtaren. 36-

vjeçari ka qenë ndër kandidatët e lidhur me Liverpoolin, si zëvendësues i mundshëm i Jurgen Klopp. Përpos kësaj, ai është në shqyrtim edhe nga Manchester United, nëse “djajtë e kuq” vendosin të ndahen nga Erik ten Hag. Nga ana tjetër, drejtori ekzekutiv i Bayern Munchen, Jan-

Christian Dreesen, ka thënë se ekziston mundësia që të rikthejë në detyrë Nagelsmann. Megjithatë, Federata Gjermane e Futbollit po punon me trajnerin, me të cilin ka një kontratë që skadon pas “Euro 2024”, që zhvillohet këtë verë. Pas fitores mbresëlënëse 2-0 të

Gjermanisë ndaj Francës, presidenti i DFB, Bernd Neuendorf, ka thënë për ZDF: “Do të ishte absolutisht e dëshirueshme nga ana jonë që Julian të qëndrojë. Ne jemi një ekip i mirë, kalojmë mirë me njëri-tjetrin dhe jemi në dialog intensiv me trajnerin. Dëshira e trajnerit

për të krijuar qartësi përpara Kampionatit Evropian tashmë është shprehur qartë. Unë kam thënë se nuk do ta injorojmë këtë dëshirë. Ky është një proces krejtësisht normal. Mendoj se tani do të kërkojmë diskutime sa më shpejt që të jetë e mundur pas dy ndeshjeve ndërkombëtare”.

SHKURT

Militao rikthehet nga lëndimi

Real Madridi është në fazën më të nxehtë të sezonit dhe gjatë kësaj faze, teknikut Carlo Ancelotti i duhen lojtarët më të mirë të formacionit. Lajm i mirë është rikthimi i qendërmbrojtësit brazilian, Eder Militao, i cili mund të jetë gati që për duelin e kësaj fundjave, ndaj Athletic Bilbao. Real është shumë afër për të siguruar titullin kampion të La Ligas, por tashmë “Los Blancos” kanë edhe një kundërshtar drithërues në çerekfinalet e Ligës së Kampionëve, teksa përballë tyre janë “Qytetarët” e Manchester City.

Ofertë astronomike nga Arabia Saudite për Dzekon

Edin Dzeko mund të largohet nga Fenerbahçe pas vetëm një sezoni, duke qenë se ka marrë një ofertë astronomike nga Arabia Saudite. Portali i njohur turk “Aksam” ka publikuar lajmin me një titull bombastik rreth ofertës së Dzekos. “Lamtumirë Edin Dzeko! Transferimi i tij për 1+1 vjet u njoftua zyrtarisht”, shkruan në ballinën e mediumit turk. Sipas njohurive të portalit turk, Dzeko ka marrë një ofertë nga Al-Hilal në vlerë prej 11 milionë euro në vit dhe duke qenë se ka mbushur 38-vjeç, është vërtet e vështirë të refuzohet. Dzeko ka kontratë me Fenerbahçen deri në verën e vitit 2025, shënoi 22 gola dhe 9 asistime në 37 ndeshje në të gjitha garat këtë sezon për skuadrën turke.

Sainz: Jeta është e çmendur, ky vit ka qenë plot surpriza deri më tani

Carlos Sainz fiton ditën e diel garën e Çmimit të Madh të Australisë në Formula 1, një triumf që erdhi dy javë pas operacionit të apandisitit. Jo vetëm kaq, por ky sukses është një hakmarrje për spanjollin, që para se të niste sezoni mësoi se nuk do të garojë me Ferrari vitin tjetër (do t'i lërë vendin Lewis Hamilton). Në garën australiane, ai përfitoi edhe nga tërheqja e Max Verstappen, të cilin e parakaloi pas dy xhirosh. Duke kujtuar këtë sukses të para 48 orëve, spanjolli më i relaksuar thotë: “Nuk ishte e lehtë fizikisht, por ia dola me ritmin dhe gomat. Garë e vështirë, por jam shumë i lumtur dhe krenar që fitova përpara Leclerc”. “Jeta është e çmendur. Kur mendoj gjithçka ndodhur në këto tri muaj më duket një çmenduri. Lajmet para sezonit, podium në Bahrein, operacioni dhe tani fitorja. Nuk e di se si mund të quhen gjithë këto situata”, ka deklaruar Sainz, që korri fitoren e tretë në karrierën e tij. “Që në xhiron e parë pata përshtypjen se mund ta parakaloja Max. Më pas ai humbi diçka dhe unë e kalova. Më pas pashë problemet e tij. Më vjen keq, pasi mendoj se do të kishim një betejë të bukur bashkë në pistë. Nga xhironja e dytë e kuptova se mund të fitoja, por rreziqet janë gjithmonë afër në sportin tonë”, ka shtuar Sainz.

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE

PËRPARIMI

VUSHTRI

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE

NPL PËRPARIMI SH.A 1 - VUSHTRRI

Nr: Protokolit: 544/24

Data: 26.03.24

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L “Përparimi” Sh. A. në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L “Përparimi” Sh. A., e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 543/24 të datës 26.03.2024 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L “Përparimi” Sh. A me datë 26.03.2024 shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Sigurim Fizik - roje

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla e Mesme apo fillore

Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik

Lartësia e pagës mujore: 390.00Euro Bruto.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të organizatës, institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit;
- Për punën që e kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes.

Kushtet e veçanta

- Shkathtësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë;
- Preferohet të jetë i licencuar në fushën e sigurimit fizik;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L “Përparimi” Sh. A - Vushtrri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen)
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 27.03.2024 deri me datë 11.04.2024 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 18.04.2024.
- Afati për ankesë nga data 19.04.2024 deri me datë 21.04.2024.
- Periodua e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 22.04.2024.
- Afati për ankesë nga data 23.04.2024 deri me datë 25.04.2024.
- Periodua e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 29.04.2024.
- Afati për ankesë nga data 30.04.2024 deri me datë 03.05.2024.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 08.05.2024.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L “Përparimi” Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. “Gjergj Kastriot Skënderbeu” nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

N.P.L “Përparimi” Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimit për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Njësia e burimeve njerëzore e ndërmarrjes do të ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët lidhur me kriteret e konkursit publik gjatë fazës së aplikimeve.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE

PËRPARIMI

VUSHTRI

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE

NPL PËRPARIMI SH.A 1 - VUSHTRRI

Nr: Protokolit: 544/24

Data: 26.03.24

U shtu s  lanom 8,  lanom 10 stav 2.2 i  lanom 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenom u Slu benom listu Republike Kosovo dana 01.12.2010. godine, u vezi s  lanom 7 Uputstva Administrativnog broj 01/2024 o uredivanju postupaka konkursa u javnom sektoru koji je dio Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenog u Slu benom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, i  lanom 8 stav 4,  lanom 11,  lanom 21 stav 2.2 i  lanom 25 Pravilnika br. 55/21 o radnom odnosu NPL „Perparimi“ Sh. A Sh. A. u Vu itru, usvojenog dana 21.12.2021. godine od strane Upravnog odbora NPL „Perparimi“ Sh. A“ Sh. A., i uzimaju i u obzir odluku sa brojem protokola 543/24 od 26.03.2024. godine od Izvr nog direktora, NPL „Perparimi“ Sh. A. 26.03.2024 objavljuje:

JAVNI KONKURS

I. Naziv: Fizi ko osiguranje –  uvar

Broj izvr itelja: 1

Radno vrijeme: 40 sati sedmi no

Trajanje imenovanja: Odre eni period od jedne (1) godine, od kojih  e  est (6) mjeseci biti probni rad, sa mogu no u produ enja.

Stru na sprema: Srednja  kola ili osnovna  kola

Radno iskustvo: Po eljno  est (6) mjeseci

Izve tava: Rukovodilac Odsjeka za fizi ko osiguranje

Visina mjese ne bruto plate: 390.00 .

Opis poslova i odgovornosti:

- Da bude sposoban da obavlja poslove radnog mjesta u punom radnom vremenu i bez ograni enja;
- Brine o osiguranju objekta i imovine organizacije, javne institucije;
- U slu aju opasnosti odmah obavje tava nadle ne osobe;
- Po potrebi mo e biti dodijeljen na drugu lokaciju radi fizi kog osiguranja;
- Obavezan je koristiti sve predvi ene za titne mjere na poslu;
- Da bude sposoban koristiti protivpo arnu  premu;
- Odgovoran je rukovodiocu Odsjeka za fizi ko osiguranje za obavljene posao;
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave predu ea.

Posebni uslovi:

- Da bude dr avljanin Republike Kosovo;
- Fizi ka sposobnost, po eljno je da ima zavr ene obuke iz oblasti sigurnosti;
- Po eljno je da ima licencu iz oblasti fizi kog osiguranja;

Uz prijavu treba dostaviti:

- Formular za prijavu NP „Napredak“ Sh. A - Vu itru.;
- Dokaz o stru noj spremi (skenirano);
- Izvod iz matične knjige ro enih; (elektronski izdatnica na platformi e-Kosova  e se prihvatiti)
- Potvrdu o neka njavanju izdatu od Stru nog vije a Kosova, da nema krivi nih osuda u centralnom krivi nom registru Republike Kosovo (elektronski izdatnica na platformi e-Kosova  e se prihvatiti);
- Dokaze o radnom iskustvu (skenirani) (nije obavezno);
- Kopiju li ne karte (skenirano);

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja istog. Objava je otvorena od datuma 27.03.2024. do datuma 11.04.2024. u 16:00 sati.

Pribli ni kalendar postupka regrutacije:

- Preliminarna verifikacija prijava kandidata najkasnije do datuma 18.04.2024.
- Rok za  albe od datuma 19.04.2024. do datuma 21.04.2024.
- Period kada  e kandidati biti podvrgnuti pisanim testovima i ocjenjivanju najkasnije do datuma 22.04.2024.
- Rok za  albe od datuma 23.04.2024. do datuma 25.04.2024.
- Period kada  e kandidati biti podvrgnuti usmenom intervjuu i ocjenjivanju najkasnije do datuma 29.04.2024.
- Rok za  albe od datuma 30.04.2024. do datuma 03.05.2024.
- Objavljivanje kona nih rezultata u vezi sa uspješnim kandidatom najkasnije do 08.05.2024.

Pribli ni kalendar postupka regrutacije mo e se produ iti ili skratiti, zavisno od toga da li je podneta  alba ili ne. U svim slu ajevima kada je podneta  alba u bilo kojoj fazi postupka regrutacije,  alba  e imati suspenzivno dejstvo dok je ista u razmatranju Komisije za  albe.

Zainteresovani kandidati mogu preuzeti formular za prijavu u Arhivskoj kancelariji NP „Napredak“ Sh. A u gradu Vu itru, ul. „Gjergj Kastriot Sk enderbeu“ br. 82, (biv a zgrada TMK-a blizu Osnovnog suda Mitrovica - ogranak u Vu itru) svakog 08:00 od 16:00.

Dostava aplikacije sa svom tra enom dokumentacijom u ovom javnom obavještenju mora se obaviti isklju ivo putem elektronske adrese kako sledi: hrperparimi@gmail.com.

NPL "Perparimi Sh. A. u Vu itru nudi jednake mogu nosti zapo ljavanja za sve gra ane Republike Kosovo.

Jedinica ljudskih resursa predu ea  e pru iti potrebna obja njenja kandidatima u vezi sa kriterijumima javnog konkursa tokom faze aplikacija.

Sva komunikacija tokom postupka javnog konkursa  e se odvijati putem elektronske komunikacije.

Napomena: Aplikacije dostavljene nakon predvi enog roka ne e biti prihva ene.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përqaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT



SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “UNDER CONTROL” Sh.P.K. me seli në Mitrovicë të Veriut, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 810170168 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "UNDER CONTROL" D.O.O. od Severna Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810170168 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “UNDER CONTROL” L.L.C. with headquarters Mitrovica e Veriut, has come to the decision to quit its business: 810170168 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Faton Jetishi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; 10,11,12,12 të shkollës mesme teknike “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.

- Astrit Simoni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Astrit Jusuf inga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; 1,2,3,4 të shkollës së mesëm teknike “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.

- Kombi Taxi Behram Hasani, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit më numër: 810361626.

- Besnik Mehmeti shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Grajçevci”.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e

veçanet me pamje nga parku me çmim
sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose
049-616-139


- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr-it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA 1992

